

STATISTIKAT E KRIMEVE DHE DREJTËSISË PENALE

2022-2024

STATISTIKAT E KRIMEVE
DHE DREJTËSISË PENALE
2022-2024

DREJTOR BOTIMI : DR. LANTONA SADO

PUNOI : ELONA SEVRANI
ALBANA BERBIU
DEANA DELAJ

© Copyright INSTAT 2026

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

PËRPUNIMI NË KOMPJUTER : ADELAJDA ALLA

INSTITUTI I STATISTIKAVE - Tiranë
Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017
Tel: + 355 4 2222411 / 2233356
e-mail: info@instat.gov.al
www.instat.gov.al

PËRMBAJTJA

Hyrja	5
Legjislacioni	6
Konceptet kryesore	6
Faktorët që duhet të mbahen parasysh kur interpretohen të dhënat mbi veprat penale	7
Ndikimi i klasifikimit sipas ICCS në rezultatet statistikore	9
Kapitulli I: VEPPA PENALE, TË DËMTUAR DHE PERSONA TË DYSHUAR	11
1.1 Vepra penale të evidentuara	11
Vrasje dhe krime seksuale	14
Femicide (Vrasja e grave dhe vajzave)	14
Krime seksuale	16
Veprat penale sipas qarqeve	16
Krimet rajonale në fokus të Eurostat	17
1.2 Persona të dëmtuar të evidentuar nga veprat penale	19
Të dëmtuar sipas veprave penale dhe gjinisë	21
Të dëmtuar sipas veprave penale dhe moshës	22
Vrasje, krime seksuale dhe trafikimi	25
1.3 Persona të dyshuar (autorë)	26
Të dyshuar sipas veprave penale dhe gjinisë	27
Të dyshuar sipas moshës	29
Të dyshuar sipas shtetësisë	31
1.4 Persona të arrestuar	32
Kapitulli II: PROCEDIME PENALE DHE TË PANDEHUR	35
2.1 Procedime penale të regjistruara	35
Procedime sipas veprave	35
Procedime sipas qarqeve	37
2.2 Të pandehur sipas veprave penale	38
Të pandehur sipas veprave	38
Të pandehur sipas gjinisë	40
Të pandehur sipas moshës	41
Të pandehur sipas qarqeve	43

Kapitulli III: TË DËNUAR	45
3.1 Të dënuar dhe të pafajshëm	45
Të dënuar sipas veprave penale dhe gjinisë	45
Të dënuar sipas veprave penale dhe moshës	48
3.2 Masat e dënimit të personave të dënuar dhe dënimet alternative	50
Masat e dënimit	50
Dënimet alternative	51
Kapitulli IV: PERSONA TË BURGOSUR	53
4.1 Të burgosur	53
Të burgosur sipas veprave penale	53
Të burgosur sipas qarqeve, grupmoshave dhe shtetësisë	54
Të burgosur sipas nivelit arsimor	56
4.2 Të dënuar me burg dhe të paraburgosur	56
Të dënuar dhe të paraburgosur sipas qarkut dhe gjinisë	56
4.3 Personeli dhe kapaciteti i burgjeve	58
Kapaciteti i burgjeve	58
Personeli në burgje	59
ANEKS 1	60
METODOLOGJIA	65
1. Burimi i të dhënave	65
2. Mbledhja e të dhënave	65
3. Klasifikimi i Veprave Penale	69
4. Përkufizime	72

HYRJA

Publikimi “Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale” përfaqëson botimin e dytë të dedikuar të INSTAT, i cili fokusohet në analizën statistikore të sistemit të drejtësisë penale në Shqipëri, duke përfshirë fazat e policisë, prokurorisë, gjykatës dhe burgjeve. Ky botim përmban të dhëna administrative për periudhën trevjeçare 2022-2024.

Qëllimi kryesor i publikimit është të ofrojë një pasqyrë të hollësishme të sistemit të drejtësisë penale, duke përfshirë në të njëjtin publikim statistika nga burimet kryesore. Publikimi paraqet në detaje gjithashtu edhe mënyrën e grumbullimit, përpunimit dhe analizës së të dhënave.

Për të siguruar krahasueshmërinë ndërkombëtare të të dhënave, seti i veprave penale në këtë publikim bazohet në Klasifikimin Ndërkombëtar të Krimeve për Qëllime Statistike (ICCS), përmes një procesi të hartëzimit të veprave penale të parashikuara në Kodin Penal me kategoritë përkatëse të ICCS. Ky klasifikim, i zhvilluar nga Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE) dhe Zyra e Kombeve të Bashkuara për Krimin dhe Drogën (UNODC), përfaqëson një kornizë të standardizuar ndërkombëtare për klasifikimin e krimeve sipas natyrës së veprës penale. Kjo qasje synon të sigurojë qëndrueshmëri, krahasueshmëri dhe përputhshmëri të të dhënave statistikore mbi kriminalitetin, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar.

Struktura e publikimit është ndarë në kapituj të veçantë sipas katër fazave kryesore të sistemit të drejtësisë penale. Për një set të caktuar të veprave penale, çdo kapitull trajton aspektet specifike të veprave, procedime penale dhe personave të përfshirë në to, si viktimat, autorët, të dyshuarit, të pandehurit, dënuar dhe burgosur.

Në mënyrë të veçantë, kapitulli i parë prezanton statistika mbi veprat penale të evidentuara nga policia, statistika mbi personat e dëmtuar, personat e dyshuar dhe arrestuar. Burimet kryesore për këtë kapitull janë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Ministria e Punëve të Brendshme.

Kapitulli i dytë i kushtohet fazës së ndjekjes penale nga ana e prokurorisë, duke paraqitur statistika mbi procedimet penale të regjistruara dhe numrin e të pandehurve sipas kategorive të veprave penale.

Kapitulli i tretë paraqet statistika mbi personat e dënuar, të ndarë sipas gjinisë, grupmoshës dhe llojit të masës së dënimit, duke u bazuar në të dhënat e Ministrisë së Drejtësisë.

Kapitulli i katërt analizon numrin e të burgosurve në institucionet penitenciare në Shqipëri, duke ofruar të dhëna sipas llojit të veprave penale, gjinisë dhe grupmoshës. Gjithashtu, paraqiten të dhëna për të dënuarit me burg, të paraburgosurit dhe të miturit në burgje.

Një seksion i dedikohet dhe metodologjisë, e cila përshkruan grumbullimin e të dhënave, mënyrën se si mbledhen të dhënat për secilin ofrues të të dhënave, përkufizimet dhe klasifikimet e përdorura për statistikën e krimeve. Gjithashtu, faktorët që duhen marrë parasysh kur krahasojmë këto statistika.

Ky publikim përfaqëson një kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e statistikave të krimeve dhe drejtësinë penale, në përputhje me standardet evropiane dhe rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare. Ai mbështet zhvillimin e politikave publike të informuara dhe efektive dhe do t'u shërbejë politikëbërësve, botës akademike, shoqërisë civile dhe përdoruesve të ndryshëm për të analizuar në një kontekst të gjerë arritjet në drejtim të përmirësimit të sigurisë, respektimit të të drejtave të njeriut dhe integritetit të praktikave më të mira ndërkombëtare.

LEGJISLACIONI

Kuadri ligjor i mëposhtëm garanton mbledhjen e të dhënave të sakta, të standardizuara dhe të krahasueshme për drejtësinë penale, në përputhje me angazhimet kombëtare dhe ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë për prodhimin e statistikave zyrtare cilësore.

Ligji nr. 17/2018, i ndryshuar, “Për statistikat zyrtare”

Ky ligj përbën bazën ligjore për funksionimin e sistemit statistikor zyrtar në Shqipëri. Ai i njeh Institutit të Statistikave (INSTAT) autoritetin për të mbledhur, përpunuar, analizuar dhe shpërndarë statistika zyrtare, duke respektuar parimet e objektivitetit, paanshmërisë, transparencës dhe konfidencialitetit statistikor.

Programi i Statistikave Zyrtare 2022–2026

Programi Pesëvjeçar i Statistikave Zyrtare për periudhën 2022–2026, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, përfshin prodhimin e statistikave për drejtësinë penale në një modul të veçantë. Ky program specifikon prodhimet statistikore të planifikuara, institucionet përgjegjëse, afatet e raportimit dhe masat për garantimin e cilësisë dhe mbrojtjen e të dhënave.

Kodi Statistikor Evropian i Praktikës

INSTAT zbaton parimet e Kodit Statistikor Evropian të Praktikës, i cili përmban 16 parime themelore për prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave evropiane. Kodi garanton që autoritetet statistikore të veprojnë në përputhje me standardet profesionale më të larta dhe me besueshmëri të plotë ndaj përdoruesve të të dhënave.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, është burimi kryesor për klasifikimin ligjor të veprave penale. Statistikat e paraqitura bazohen në klasifikimin ligjor të veprave penale sipas Kodit Penal dhe janë harmonizuar me Klasifikimin Ndërkombëtar të Krimeve për Qëllime Statistikore (ICCS) të miratuar nga Kombet e Bashkuara.

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë

Ligji nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullon ecurinë e procedurave penale dhe përcakton fazat përkatëse (hetim, ndjekje penale, gjykim, ekzekutim), të cilat janë të rëndësishme për strukturimin dhe interpretimin e statistikave përkatëse.

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur

Ligji nr. 37/2017, datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit”, përcakton rregullat procedurale dhe materiale për të miturit në konflikt me ligjin dhe është bazë për prodhimin e statistikave të veçanta për këtë grupmoshë.

KONCEPTET KRYESORE

Ky seksion përmbledh përkufizimet kryesore të përdorura në raportin mbi statistikat e drejtësisë penale. Përkufizime të tjera të detajuara dhe tregues statistikorë specifikë paraqiten në kapitullin mbi Metodologjinë.

Vepra penale: Çdo sjellje (veprim ose mosveprim) që cenon ose dëmton vlerat juridike të mbrojtura me ligj. Ato ndahen në krime dhe kundërvajtje penale, bazuar në natyrën dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës.

Autor: Personi që kryen drejtpërdrejt veprën penale ose merr pjesë në kryerjen e saj në mënyrën e parashikuar nga ligji. Sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, përgjegjësia penale fillon në moshën 14 vjeç për krimet dhe në moshën 16 vjeç për kundërvajtjet penale.

I dëmtuar: Sipas Kodit të Procedurës Penale, i dëmtuar është çdo person fizik apo juridik të cilit, nga një veprë penale, i është cenuar një e drejtë ose interes i ligjshëm, personal apo pasuror.

I mitur: Për qëllime statistikore dhe në përputhje me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, i mitur konsiderohet çdo person nën moshën 18 vjeç.

I mitur në konflikt me ligjin: Person që ka mbushur moshën 14 vjeç dhe është nën 18 vjeç, ndaj të cilit ekziston dyshimi i arsyeshëm për kryerjen e një veprë penale, është marrë si i pandehur dhe/ose është dënuar me vendim të formës së prerë. Në vazhdim të këtij botimi, termi “i mitur” do përdoret për këtë kategori (mosha 14–17 vjeç).

I rritur: Person që ka mbushur moshën 18 vjeç në momentin e kryerjes së veprës penale.

I pandehur: Sipas nenit 34 të Kodit të Procedurës Penale, i pandehur është personi ndaj të cilit është ngritur zyrtarisht akuza për një veprë penale, përmes aktit të njoftimit të akuzës nga prokuroria.

I dënuar: Person ndaj të cilit është dhënë një vendim gjyqësor i formës së prerë që e shpall fajtor për kryerjen e një veprë penale dhe ndaj të cilit janë vendosur masa ndëshkuese penale, përfshirë dënimin me burgim, gjobë, ose masa të tjera alternative.

I paraburgosur: Person ndaj të cilit është dhënë një masë sigurie personale “arrest në burg”, gjatë fazës së hetimit ose gjykimit, por që ende nuk është dënuar me vendim përfundimtar. Përfshihen si shtetas shqiptarë ashtu edhe të huaj.

I dënuar me burg: Person i dënuar me dënim me burgim nga gjykatat shqiptare me vendim të formës së prerë. Përfshihen edhe të dënuar nga gjykata të huaja, kur dënimi njihet nga shteti shqiptar në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Të burgosur: Persona që mbahen në institucione të ekzekutimit të vendimeve penale, përfshirë: burgjet, institucionet për të mitur, qendrat e paraburgimit, spitalet psikiatrike me masa sigurimi penal dhe struktura të tjera të ngjashme. Kjo kategori përfshin si personat e dënuar, ashtu edhe personat nën masë paraburgimi.

Të arrestuar: Persona ndaj të cilëve organet e Policisë së Shtetit kanë zbatuar masën e arrestimit në flagrancë ose të ndalimit, për shkak të dyshimit të arsyeshëm për kryerjen e një veprë penale, duke i privuar përkohësisht nga liria në përputhje me legjislacionin në fuqi.

FAKTORËT QË DUHET TË MBAHEN PARASYSH KUR INTERPRETOHEN TË DHËNAT MBI VEPRAT PENALE

Statistikat mbi veprat penale dhe individët që përfshihen në sistemin e drejtësisë nuk përfaqësojnë numrin e saktë të krimeve që ndodhin në shoqëri apo të gjithë personat që kryejnë krime. Ato pasqyrojnë vetëm rastet që janë identifikuar dhe regjistruar nga institucionet e drejtësisë. Për këtë arsye, kur interpretojmë të dhënat mbi kriminalitetin, është e rëndësishme të kemi parasysh faktorët e mëposhtëm:

- *Ndikimi i faktorëve të jashtëm në hyrjet në sistemin e drejtësisë*

Ndryshimet vjetore në numrin e veprave penale mund të pasqyrojnë ndryshime në sjelljen e raportimit nga qytetarët, e cila ndikohet nga faktorë të tillë si: niveli i tolerancës shoqërore ndaj veprave të caktuara penale, nismat ndërgjegjësuere në komunitet dhe rritja e vëmendjes mediatike ndaj disa kategorive të krimeve. Këta faktorë ndikojnë veçanërisht në raportimin e veprave penale si dhuna ndaj personit, vjedhjet, etj.

- Ndikimi i burimeve dhe përpjekjeve të sistemit të drejtësisë

Shkalla e zbulimit të veprave penale ndikohet nga burimet në dispozicion dhe përpjekjet e institucioneve të zbatimit të ligjit. Për shembull: një intensifikim i kontrolleve në trafik mund të çojë në rritje të shkeljeve të regjistruara ose një fokus më i madh te krimet në fushën e drogës sjell më shumë raste të identifikuar.

Statistikat ndryshojnë brenda të njëjtit shtet

Të dhënat mbi veprat penale dhe drejtësinë penale mund të ndryshojnë dukshëm brenda të njëjtit juridiksion, në varësi të fazës së procesit penal ku regjistrohen. Secili institucion në sistemin e drejtësisë mbledh dhe përpunon statistika sipas funksioneve dhe nevojave të veta, duke përdorur metoda të ndryshme të matjes dhe kohë të ndryshme referimi. Për rrjedhojë, statistikave paraqitura në kapitujt apo burimet e ndryshme janë të vështira për t'u krahasuar drejtpërdrejt ose për t'u analizuar në mënyrë të unifikuar. Kjo sjell disa kufizime që duhen pasur parasysh në rastet kur:

- Numri i personave të dyshuar të regjistruar gjatë një viti nuk është krahasues me numrin e të pandehurve për të njëjtin vit, pasi shumë nga të pandehurit mund të jenë hetuar dhe regjistruar si të dyshuar në një periudhë të mëparshme (p.sh. një vit më parë);
- Numri i të pandehurve të regjistruar gjatë një viti nuk është krahasues me numrin e të dënuarve të regjistruar në të njëjtin vit, pasi vendimet gjyqësore mund të jenë marrë më vonë, ndoshta pas disa muajsh ose edhe një viti nga momenti i akuzës.

Për këtë arsye, është thelbësore që të dhënat statistikore të interpretohen në një kontekst më të gjerë kohor dhe në lidhje me fazën përkatëse të procesit penal, në vend që të krahasohen drejtpërdrejt vlerat numerike të regjistruara brenda të njëjtit vit kalendarik. Një analizë efektive kërkon vlerësimin e trendeve ndër vite dhe jo thjesht krahasimin mes kategorive të ndryshme brenda të njëjtit vit.

Statistikat ndryshojnë mes shteteve

Krahasimi i drejtpërdrejtë i statistikave të kriminalitetit dhe drejtësisë penale ndërmjet vendeve shpesh është i papërshtatshëm dhe mund të çojë në interpretim të gabuar të realitetit. Kjo ndodh për disa arsye të rëndësishme që lidhen me mënyrën se si secili vend organizon dhe operon sistemin e tij të drejtësisë penale.

Disa vende kanë sisteme të së drejtës civile, të tjera të së drejtës zakonore, dhe kjo ndikon drejtpërdrejt në mënyrën si trajtohen veprat penale. Çfarë konsiderohet vepër penale në një vend mund të mos jetë e tillë në një tjetër. Përkufizimet ligjore bazohen në kode penale kombëtare që nuk janë të unifikuar. Disa shtete mund të mbledhin të dhëna për të gjithë territorin, ndërsa të tjera vetëm për rajone të caktuara. Po ashtu, periudhat e raportimit mund të ndryshojnë (vit kalendarik, vit fiskal, etj). Të dhënat mund të regjistrohen në momente të ndryshme të procesit penal, si: në momentin kur një vepër penale raportohet për herë të parë, gjatë ose pas hetimit të plotë dhe në rastin e statistikave gjyqësore, para ose pas apelimit të një çështjeje. Kjo do të thotë se institucionet që regjistrojnë të dhëna në një fazë më të hershme (si policia në momentin e raportimit) mund të paraqesin numra dukshëm më të lartë, krahasuar me vende ku regjistrimi ndodh pas verifikimit ose përfundimit të procedurës. Mënyra se si numërohen veprat penale, rastet apo individët (p.sh. një rast për person apo për vepër) mund të ndryshojë ndjeshëm mes vendeve dhe ndikon në krahasueshmërinë e statistikave.

NDIKIMI I KLASIFIKIMIT SIPAS ICCS NË REZULTATET STATISTIKORE

Në fushën e statistikave të krimeve dhe drejtësisë penale, INSTAT publikon të dhëna vjetore të bazuara në nenet e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Ndërkohë, në këtë botim veprat penale janë klasifikuar sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Krimeve për Qëllime Statistike (ICCS).

Ndryshe nga Kodi Penal, i cili bazohet në *strukturën juridike* të veprave penale, ICCS i klasifikon ato sipas *natyrës së kimit*, duke mundësuar krahasueshmëri ndërkombëtare të statistikave.

Për shkak të dallimeve metodologjike midis dy qasjeve, disa nene të Kodit Penal janë rigrupuar në kategori të ndryshme sipas ICCS, çka sjell ndryshime në numrin e rasteve të raportuara për disa vepra penale krahasuar me publikimet e mëparshme. Këto ndryshime vijnë si rezultat i zbatimit të metodologjisë ICCS, e cila kërkon përfshirjen ose përjashtimin e disa neneve të Kodit Penal nga kategori të caktuara të veprave penale. Krahasimi midis dy klasifikimeve tregon diferenca në grupimin e disa veprave, veçanërisht në kategoritë e mashtrimeve, shkeljeve të rregullave të qarkullimit rrugor dhe krimeve në fushën e drogës.

Vepra penale	Diferenca midis grupimit nga ICCS dhe grupit nga Kodi Penal
Vrasje me dashje	82, 83, 141 (Përfshirje në ICCS)
Vjedhje me dhunë	140 (Përfshirje në ICCS)
Mashtrime	147, 148, 149, 149/a, 149/b (Përjashtime në ICCS)
Krime në fushën e drogës	283/b, 284/ç, 285, 285/a, 285/b, 286, 286/a (Përfshirje në ICCS)
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	273 (Përjashtime në ICCS)
Trafikimi i armëve dhe i municionit	282/a (Përfshirje në ICCS)

Për të ilustruar ndikimin e klasifikimit ICCS, është kryer një analizë krahasuese bazuar vetëm në të dhënat e Policisë së Shtetit. Rezultatet tregojnë se ndryshimet në grupim reflektohen edhe në statistikën e publikuara. Diferencat më të mëdha vërehen në shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor dhe mashtrimet, ndërsa në disa kategori si vrasja me dashje dhe vjedhja me dhunë, ndryshimet janë më të vogla dhe tregojnë një përputhje më të lartë midis dy klasifikimeve. Në disa raste, si krimet në fushën e drogës, vërehet rritje e numrit të rasteve për shkak të përfshirjes më të gjerë të veprave sipas ICCS.

Diferencat numerike (Kod Penal - ICCS)	2022	2023	2024
Vrasje me dashje	2	1	1
Vjedhje me dhunë	13	9	6
Mashtrime	-93	-54	-41
Krime në fushën e drogës	69	59	26
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	-373	-321	-332
Trafikimi i armëve dhe i municionit	4	0	2

Zbatimi i klasifikimit ICCS sjell ndryshime në numrin e rasteve të raportuara për disa kategori veprash penale, si rezultat i klasifikimit të neneve sipas natyrës së veprës penale. Gjithashtu, ICCS kontribuon në harmonizimin e statistikave shqiptare me standardet e Eurostat dhe UNODC, rrit krahasueshmërinë ndërkombëtare dhe përbën një hap të rëndësishëm në përafrimin me kërkesat e Bashkimit Evropian.

1

VEPRA PENALE, TË DËMTUAR DHE PERSONA TË DYSHUAR



VEPRA PENALE, TË DËMTUAR DHE PERSONA TË DYSHUAR

Ky kapitull paraqet të dhëna mbi veprat penale të evidentuara, personat e dyshuar dhe personat e dëmtuar, sipas llojit të veprave penale të kryera gjatë një viti, si dhe karakteristikat e tyre demografike.

Statistikat e paraqitura bazohen në klasifikimin ligjor të veprave penale sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë dhe janë harmonizuar me Klasifikimin Ndërkombëtar të Krimeve për Qëllime Statistikore (ICCS).

1.1 VEPRA PENALE TË EVIDENTUARA

Statistikat mbi veprat penale të evidentuara japin një pamje gjithëpërfshirëse të të gjithë rasteve të


evidentuara dhe raportuara në polici, gjatë një viti kalendarik (1 janar- 31 dhjetor). Për një ngjarje të caktuar, policia regjistron dhe numëron të gjithë veprat penale dhe jo vetëm veprën më të rëndë penale.

Në Shqipëri, në vitin 2024, u evidentuan gjithsej 32.653 vepra penale, duke shënuar një rënie me 3,5 %, krahasuar me vitin e kaluar, dhe një rënie me 2,5 % krahasuar me vitin 2022.

Në setin e veprave penale të analizuara, në 2024, veprat penale si shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor zënë peshën më të madhe në totalin e veprave me 16,5 %, ndjekur nga veprat penale në fushën e drogës me 8,9 %, dhuna në familje 6,6 %, vjedhje 6,5 % dhe trafikimi i armëve dhe i municionit 4,2 %.

FIG. 1

Ndryshimi në përqindje i veprave penale, 2024-2023



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

TAB. 1


Vepra penale të evidentuara sipas llojit të veprave

Vepra penale	2022	2023	2024
Vrasje me dashje	44	35	41
Vrasje të mbetura në tentativë	93	94	83
Shkaktim vetvrasje	24	35	50
Kanosja	910	1.045	1.051
Plagosje e rëndë me dashje	145	137	150
Plagosje e lehtë me dashje	831	910	887
Përdhunimi	49	46	43
Abuzime seksuale	112	84	95
Trafikimi i qenieve njerëzore	32	37	59
Dhuna në familje (neni 130/a)	1.887	1.911	2.139
Shfrytëzim prostitucioni	107	114	109
Pornografia	120	38	73
Përndjekje	158	196	232
Vjedhje	2.661	2.712	2.133
Vjedhje me shpërdorim detyre	97	41	47
Vjedhje me dhunë	78	89	80
Mashtrime	969	949	802
Fallsifikim monedhash	51	26	34
Punësim i paligjshëm	141	156	158
Pastrimi i parave	475	387	421
Krime në fushën e drogës	2.956	3.105	2.908
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	5.309	5.230	5.382
Krime kibernetike	152	276	388
Trafikimi i armëve dhe i municionit	1.341	1.404	1.358
Vepra penale të lidhura me organizatat kriminale	60	64	58
Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror	606	607	496
Dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit	418	210	112
Shtrengim ose pengim për të bashkëjetuar ose zgjidhur martesën	17	8	3
Korrupsion	568	347	279
Abuzim detyre	605	526	440
Ndërtim i paligjshëm	1.244	1.464	1.338
Vepra penale kundër mjedisit	571	532	432
Vepra penale të paklasifikuara	10.645	11.030	10.772
Gjithsej	33.476	33.845	32.653

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

FIG. 2

Vepra penale gjithsej të evidentuara për 10 mijë banorë



Vrasje dhe krime seksuale

Në vitin 2024, janë evidentuar 41 vrasje me dashje, 6 raste më shumë, krahasuar me vitin e kaluar. Krahasuar me 2022, janë evidentuar 3 vrasje me dashje më pak.

Në 2024, në totalin e vrasjeve me dashje, vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare (neni 79/c) zënë 22,0 %.

Për periudhën 10 vjeçare, viti 2015 dhe 2023 shënon në totalin e vrasjeve me dashje përqindjen më të lartë të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, respektivisht 31,6 % dhe 28,6 %.

Ndërkohë, në vitin 2020 vihet re përqindja më e ulët e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, me 13,0 %.

Femicide (Vrasja e grave dhe vajzave)

Femicidi njihet si forma më ekstreme dhe më e dhunshme e dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave, e pranishme në të gjitha vendet dhe rajonet e botës. Në përkufizim, femicidi nënkupton vrasjen e grave dhe vajzave për arsye të lidhura me gjininë e tyre. **Ky fenomen dallon nga llojet e tjera të vrasjeve, pasi i referohet vrasjes së një gruaje/vajze vetëm për shkak se ajo është femër.**

Figura më poshtë paraqet ecurinë e femicidit, vrasjeve me dashje dhe vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare për vitet 2022-2024. Nga të dhënat vihet re se, viti 2024 regjistron numrin më të ulët të viktimave në të gjitha kategoritë, ndërsa vitet 2022 dhe 2023 tregojnë rritje të numrit të vrasjeve ndaj femrave dhe rritje të vrasjeve të tyre për shkak të marrëdhënieve familjare.

FIG. 3

Numri i vrasjeve me dashje dhe përqindja e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, 2015-2024





FIG. 4

Femicidi, viktima femra të vrasjeve me dashje dhe vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare, në numër



Burimi: Avokati i Popullit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, INSTAT


Grafiku paraqet vrasjet e grave dhe vajzave dhe femicide sipas grupmoshës, gjithsej për të tre vitet 2021-2023. Nga grafiku vihet re se grupmosha 45-59 vjeç ka numrin më të lartë të viktimave si për vrasje (11), ashtu edhe për femicide (9). Kjo tregon se gratë në moshë të mesme përballen më shpesh me forma ekstreme të dhunës, shpesh të lidhura me marrëdhënie familjare ose partnerë afatgjatë.

Grupmosha 30-44 vjeç renditet e dyta, me 10 vrasje dhe 7 femicide, duke reflektuar ekspozim të lartë ndaj dhunës në periudhën e jetës aktive dhe familjare.

Grupmosha 15-29 vjeç ka numër më të ulët të viktimave (4 vrasje dhe 4 femicide), ndërkohë grupmosha 60+ përfshin 7 vrasje dhe 4 femicide.

FIG. 5

Vrasja e grave dhe vajzave dhe femicidi sipas grupmoshës, 2021-2023




Burimi: Avokati i Popullit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, INSTAT

Krime seksuale

Përgjatë 10 viteve të fundit, numri i veprave penale të krimeve seksuale ka pësuar luhatje. Në vitin 2024, këto vepra janë rritur me 13,8 %, krahasuar me vitin 2015. Ndërkohë, për të njëjtën periudhë, numri i veprave penale të përdhunimit pothuajse është përgjysmuar (rënie prej 46,3 %).

FIG. 6

Numri i veprave penale të dhunës seksuale dhe përdhunimit, 2015-2024



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, INSTAT

Veprat penale sipas qarqeve

Në vitin 2024, analiza sipas qarqeve e veprave penale të evidentuara nga policia tregon një rënie pothuajse në të gjitha qarqet, krahasuar me vitin 2023. Përjashtim bën qarku i Shkodrës dhe Elbasanit, ku veprat penale janë rritur respektivisht me 28,4 % dhe 7,1 %.

Nga figura vihet re që, qarku i Tiranës dhe Durrësit zënë peshën më të madhe të veprave penale të evidentuara ndaj totalit, respektivisht me 34,1 % dhe 11,9 %.



TAB.2


Vepra të evidentuara gjithsej sipas qarqeve

Qarku	2022	2023	2024
Berat	1.215	1.062	1.036
Dibër	823	678	665
Durrës	3.824	4.079	3.891
Elbasan	1.984	2.219	2.377
Fier	2.183	2.136	2.128
Gjirokastrë	977	875	763
Korçë	2.064	1.998	1.866
Kukës	796	756	700
Lezhë	1.766	1.842	1.781
Shkodër	1.943	1.863	2.392
Tiranë	12.659	12.791	11.130
Vlorë	2.653	2.448	2.404
DPP	589	1.098	1.520
Shqipëria	33.476	33.845	32.653

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Shënim: DPP përfshin rastet e evidentura nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

FIG. 7

Përqindja e veprave penale sipas qarqeve, viti 2024



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, INSTAT

Krimet rajonale në fokus të Eurostat

Të dhënat rajonale mbi krimin, në përputhje me metodologjinë e Eurostat, bazohen në veprat penale të regjistruara nga policia si vrasje me dashje, plagosje dhe vjedhje, të cilat kategorizohen sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Krimeve për Qëllime Statistike (ICCS), duke mundësuar një analizë krahasimore mes qarqeve (NUTS 3).

Vrasjet janë të rralla dhe të shpërndara kryesisht në qytetet më të mëdha. Shumica e qarqeve raportojnë numër të ulët të vrasjeve (zakonisht 0–5 në vit për qarqe të vogla). Qarqet me shifra më të larta janë Tiranë, Shkodër, Vlorë dhe Durrës (zakonisht 6–11 vrasje), gjatë viti 2024.


Plagosjet janë veprat më të zakonshme në shumicën e qarqeve. Ka një rritje më të lartë në qarqet e mëdha si Tiranë, Durrës, Elbasan, ku numri i rasteve pothuajse është dyfishuar nga 2022 në 2024. Në qarqet Berat, Dibrë, Kukës, Gjirokastër gjithashtu vihet re rritje, por me nivele më të ulëta.

Shumica e vjedhjeve të analizuara ndodhin në qarqet e mëdha dhe tregojnë fluktuacione të ndjeshme nga viti në vit. Qarqet më të prekura janë Tirana, Durrësi, Vlorë dhe Korça.



HARTA 1

Krimet rajonale, 2024



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, INSTAT


1.2 PERSONA TË DËMTUAR TË EVIDENTUAR NGA VEPRAT PENALE

Të dëmtuar u referohen personave që janë dëmtuar nga kryerja e një vepre penale gjatë një viti. Ky seksion paraqet të dhëna mbi të dëmtuarit sipas gjinisë, grupmoshës dhe qarqeve.

Në 2024, janë evidentuar gjithsej 17.761 persona të dëmtuar, duke shënuar një rritje me 4,3 %, krahasuar me vitin e kaluar. Ndërkohë, krahasuar me 2022, janë evidentuar 30,1% më shumë të dëmtuar. Analizuar sipas gjinisë, në 2024, janë evidentuar 5.219 femra (29,4 %) dhe 12.542 meshkuj të dëmtuar (70,6 %).

FIG. 8


Numri i të dëmtuarve gjithsej



Në vitin 2024, qarku i Lezhës dhe Durrësit zënë peshën më të madhe të të dëmtuarve për 10.000 banorë, respektivisht me 105.1 dhe 103.1.

HARTA 2

Të dëmtuar për 10.000 banorë, 2024



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, INSTAT

Të dëmtuar sipas veprave penale dhe gjinisë

Gjatë viteve 2022-2024, femrat e dëmtuara dominojnë në veprat penale si dhuna në familje, përndjekja, abuzime seksuale, përdhunimi dhe shfrytëzim prostitucioni. Ndërkohë, personat e dëmtuar që kanë përfshirjen më të madhe në veprat e tjera janë meshkujt.

TAB.3

Të dëmtuar gjithsej sipas llojit të veprave penale dhe gjinisë


Vepra penale	2022		2023		2024	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
Vrasje me dashje	47	9	37	11	48	8
Vrasje të mbetura në tentativë	73	8	102	10	85	8
Shkaktim vetvrasje	11	13	19	13	25	25
Kanosja	651	180	824	249	798	248
Plagosje e rëndë me dashje	145	6	157	6	159	9
Plagosje e lehtë me dashje	767	70	974	81	928	60
Përdhunimi	5	35	12	31	6	33
Abuzime seksuale	21	75	9	70	19	84
Trafikimi i qenieve njerezore	*	4	6	3	19	7
Dhuna në familje (neni 130/a)	583	1.371	685	1.378	804	1.456
Shfrytëzim prostitucioni	*	11	3	13	*	15
Pornografia	*	*	*	3	6	10
Përndjekje	29	116	65	129	79	152
Vjedhje	1.764	425	1.970	516	1.609	373
Vjedhje me dhunë	41	16	71	21	55	18
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	20	13	19	3	30	4
Mashtrime	482	133	499	180	495	160
Fallsifikim monedhash	17	5	9	*	17	4
Punësim i paligjshëm	12	7	12	22	27	21
Pastrimi i parave	*	*	4	*	5	*
Krime në fushën e drogës	*	3	9	6	19	4
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	1.747	677	2.445	874	2.700	928
Krime kibernetike	55	47	114	78	203	150
Trafikimi i armëve dhe i municionit	89	19	167	22	267	36
Vepra penale të lidhura me organizatat kriminale	*	*	*	*	*	*
Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror	*	*	3	*	*	*
Dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit	*	*	13	5	*	*
Shtrengim ose pengim për të bashkëjetuar ose zgjidhur martesën	5	8	2	7	*	*
Korrupsion	9	*	17	3	9	5
Abuzim detyre	48	19	41	15	89	24
Ndërtim i paligjshëm	6	3	27	*	63	8
Vepra penale kundër mjedisit	46	12	39	9	48	11
Vepra penale të paklasifikuara	2.770	913	3.686	1.217	3.926	1.356
Gjithsej	9.450	4.200	12.040	4.981	12.542	5.219

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Shënim: *Vlera të fshehura për arsye të konfidencialitetit

Figura 9 paraqet përqindjen e femrave të dyshuara, të dëmtuara nga veprat penale, të pandehura dhe të burgosura në raport me totalin e personave për secilën kategori. Nga të dhënat vihet re një përqindje e ulët e femrave të përfshira në sistemin e drejtësisë. Megjithatë, në kategorinë e të dëmtuarave nga veprat penale, përqindja e femrave është më e lartë krahasuar me fazat e tjera të sistemit të drejtësisë. Kjo tregon se femrat preken më shumë si viktime të veprave penale, ndërsa pjesëmarrja e tyre si të dyshuara, të pandehura apo të burgosura mbetet më e ulët.

FIG. 9

Femra të përfshira në sistemin e drejtësisë, 2024




Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Prokuroria e Përgjithshme, INSTAT

Të dëmtuar sipas veprave penale dhe moshës

Gjatë vitit 2024, janë evidentuar 1.447 të mitur të dëmtuar (nën 18 vjeç) dhe 16.314 të rritur (18 vjeç e lart). Numri i të miturve dhe të rriturve të dëmtuar ka pësuar rritje gjatë periudhës 2022- 2024, respektivisht 36,8 % dhe 29,6 %.

FIG. 10

Përqindja e personave të dëmtuar të rritur dhe mitur



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, INSTAT

Për shumicën e kategorive të veprave penale, shumica e personave të dëmtuar janë të rritur. Në krahasim me të rriturit, në veprat penale si përdhunimi, abuzime seksuale, trafikimi i qënieve njerëzore dhe pornografia të miturit janë më të evidentuar.

Në vitin 2024, rreth një e treta e të miturve të dëmtuar janë evidentuar në veprat penale shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor (31,8 %), dhuna në familje (7,8 %) dhe plagosje e lehtë me dashje (7,5 %).

TAB.4

Të dëmtuar gjithsej sipas llojit të veprave penale dhe grupmoshës

Vepra penale	2022		2023		2024	
	Mitur	Rritur	Mitur	Rritur	Mitur	Rritur
Vrasje me dashje	0,3%	0,4%	0,3%	0,3%	0,3%	0,3%
Vrasje të mbetura në tentativë	0,3%	0,6%	0,3%	0,7%	0,5%	0,5%
Shkaktim vetvrasje	0,2%	0,2%	0,1%	0,2%	0,6%	0,3%
Kanosja	4,1%	6,2%	3,2%	6,6%	4,4%	6,0%
Plagosje e rëndë me dashje	1,7%	1,1%	1,7%	0,9%	1,5%	0,9%
Plagosje e lehtë me dashje	10,0%	5,8%	8,4%	6,0%	7,5%	5,4%
Përdhunimi	2,4%	0,1%	1,7%	0,1%	1,5%	0,1%
Abuzime seksuale	4,9%	0,3%	3,2%	0,2%	3,6%	0,3%
Trafikimi i qënieve njerëzore	0,2%	0,0%	0,3%	0,0%	1,0%	0,1%
Dhuna në familje (neni 130/a)	10,1%	14,7%	8,4%	12,5%	7,8%	13,2%
Shfrytëzim prostitucioni	0,1%	0,1%	0,5%	0,1%	0,2%	0,1%
Pornografia	0,0%	0,0%	0,2%	0,0%	0,6%	0,0%
Përndjekje	2,4%	1,0%	1,7%	1,1%	1,8%	1,3%
Vjedhje	3,3%	17,1%	3,1%	15,7%	3,0%	11,9%
Vjedhje me dhunë	0,5%	0,4%	0,9%	0,5%	0,6%	0,4%
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	0,0%	0,3%	0,0%	0,1%	0,0%	0,2%
Mashtrime	1,3%	4,8%	0,1%	4,3%	0,3%	4,0%
Fallsifikim monedhash	0,0%	0,2%	0,1%	0,1%	0,0%	0,1%
Punësim i paligjshëm	0,1%	0,1%	0,0%	0,2%	0,1%	0,3%
Pastrimi i parave	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%
Krime në fushën e drogës	0,2%	0,0%	0,1%	0,1%	0,6%	0,1%
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	28,4%	16,9%	35,2%	18,0%	31,8%	19,4%
Krime kibernetike	0,4%	0,8%	1,0%	1,1%	1,5%	2,0%
Trafikimi i armëve dhe i municionit	0,8%	0,8%	1,8%	1,0%	2,6%	1,6%
Vepra penale të lidhura me organizatat kriminale	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%
Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror	0,0%	0,0%	0,1%	0,0%	0,0%	0,0%
Dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit	0,0%	0,0%	0,1%	0,1%	0,0%	0,0%
Shtërngim ose pengim për të bashkëjetuar ose zgjidhur martesën	0,3%	0,1%	0,1%	0,1%	0,0%	0,0%
Korrupsion	0,0%	0,1%	0,0%	0,1%	0,0%	0,1%
Abuzim detyre	0,1%	0,5%	0,0%	0,4%	0,0%	0,7%
Ndërtim i paligjshëm	0,0%	0,1%	0,0%	0,2%	0,1%	0,4%
Vepra penale kundër mjedisit	0,2%	0,4%	0,0%	0,3%	0,4%	0,3%
Gjithsej	1.058	12.592	1.447	15.574	1.447	16.314

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Shënim: * Vlera të fshehura për arsye të konfidencialitetit

Në vitin 2024, nga totali i të miturve të dëmtuar, 401 ishin vajza dhe 1,046 djem. Veprat penale që lidhen me shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor, dhunën në familje dhe dëmtimet me dashje kanë regjistruar numrin më të madh të të miturve të dëmtuar.

Diferenca gjinore është më e dallueshme në rastet e krimeve seksuale dhe dhunës në familje, ku përqindja e vajzave të dëmtuara është më e lartë se ajo e djemve. Ndërkohë, në veprat penale si plagosjet, dëmtimet me dashje dhe shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor dominojnë djemtë.

TAB.5

Të mitur të dëmtuar sipas veprave penale dhe gjinisë

Të mitur të dëmtuar	2022		2023		2024	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
Vrasje e foshnjës	0,1%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,2%
Kanosje	4,5%	2,8%	3,6%	2,0%	4,3%	4,2%
Plagosje e lehtë me dashje	13,0%	1,8%	11,0%	1,5%	10,0%	1,0%
Dëmtime të tjera me dashje	12,0%	2,1%	12,1%	2,8%	14,4%	3,2%
Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur	0,1%	4,3%	0,3%	3,8%	0,2%	3,2%
Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç	0,4%	2,8%	0,1%	0,8%	0,0%	1,5%
Vepra të turpshme	1,3%	2,8%	0,2%	1,8%	0,2%	2,5%
Ngacmim seksual	0,3%	11,3%	0,4%	8,4%	0,7%	8,2%
Heqja e paligjshme e lirisë	1,3%	1,8%	0,5%	0,5%	0,4%	0,0%
Përndjekja	0,4%	7,8%	0,5%	5,1%	1,1%	3,7%
Braktisja e fëmijëve të mitur	1,9%	2,1%	2,7%	1,5%	1,1%	1,0%
Keqtrajtimi i të miturit	5,3%	4,3%	4,8%	8,7%	4,8%	5,2%
Marrja e padrejtë e fëmijës	0,6%	0,0%	1,3%	0,8%	0,4%	0,7%
Ndërrimi i fëmijëve	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%
Trafikimi i të miturve	0,0%	0,7%	0,2%	0,8%	1,3%	0,2%
Shtytja e të miturve në krim	0,3%	0,0%	0,3%	0,0%	0,2%	0,0%
Fshehja ose ndërrimi me dashje i fëmijës	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%
Dhuna në familje	7,7%	16,7%	5,1%	17,3%	5,0%	15,2%
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	34,5%	28,0%	39,9%	27,7%	37,5%	25,4%
Marrje shpërblim për procese birësimi	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%
Krime kibernetike	0,1%	0,7%	0,7%	1,8%	0,5%	4,0%
Gjithsej	776	282	1.054	393	1.046	401

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, INSTAT


Vrasje, krime seksuale dhe trafikimi

Të dhënat për periudhën 2015–2024 tregojnë se numri i personave të dëmtuar nga vrasjet me dashje ka pësuar luhajtje të ndjeshme, duke arritur vlerën më të lartë në vitin 2016 me 106 raste dhe nivelin më të ulët në vitin 2023 me 48 raste. Gjithashtu edhe përqindja e vrasjeve të lidhura me marrëdhëniet familjare ka pësuar luhajtje, duke zbritur nga 23,3 % në vitin 2015 në 16,1 % në vitin 2024.

Nga analiza e të dhënave për periudhën 2015–2024 vërehet se numri i personave të dëmtuar nga dhuna seksuale paraqet një tendencë të përgjithshme rritëse, duke kaluar nga 106 persona në vitin 2015 në 124 persona në vitin 2024. Në të kundërt, numri i personave të dëmtuar nga përdhunimi ndjek një prirje rënëse, duke zbritur nga 78 persona në vitin 2015 në vetëm 39 persona në vitin 2024. Këto të dhëna tregojnë se, megjithëse është rritur numri i personave të dëmtuar nga dhuna seksuale, numri i personave të dëmtuar nga përdhunimi ka pësuar një ulje të ndjeshme gjatë periudhës së analizuar.

FIG.11


Të dëmtuar nga vrasjet me dashje, 2015-2024



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, INSTAT

FIG.12

Të dëmtuar nga dhuna seksuale dhe përdhunimi, 2015-2024



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, INSTAT

Lidhur me trafikimin e qënieve njerëzore, numri i viktimave ka ardhur në rritje përgjatë viteve 2022-2024. Në vitin 2024, viktimat e trafikimit janë rritur me 7,9 % krahasuar me vitin paraardhës.

Nga totali i viktimave, 36,5 % janë meshkuj dhe 63,5 % janë femra. Sipas grupmoshës, të miturit zënë peshën më të madhe në veprat e trafikimit, përkatësisht 53,9 %.

Në 2022 dhe 2023, vajzat e mitura zënë përqindjen më të madhe, respektivisht me 64,9 % dhe 61,5 %, ndërkohë në 2024 vihet re një barazi gjinorë në trafikim.

Treguesi në raport me popullsinë pësoi rritje nga 4.0 në vitin 2022 në 7.5 në vitin 2024, me vlera më të larta te femrat dhe ritëm më të shpejtë rritjeje te meshkujt, ndërsa në vitin 2024 u vërejt një ulje e lehtë e treguesit te femrat.

TAB.6

Viktima të trafikimit të qënieve njerëzore sipas gjinisë, grupmoshës, dhe normës për 100.000 banorë

Viti		2022	2023	2024
Gjithsej	Numër	112	165	178
	Norma	4.0	6.8	7.5
	0-17 vjeç	74	109	96
	18 vjeç e sipër	38	56	82
Meshkuj	Numër	31	50	65
	Norma	2.3	4.2	5.5
	0-17 vjeç	26	42	48
	18 vjeç e sipër	5	8	17
Femra	Numër	81	115	113
	Norma	5.8	9.5	9.4
	0-17 vjeç	48	67	48
	18 vjeç e sipër	33	48	65

Burimi: Ministria e Brendshme, INSTAT



1.3 PERSONA TË DYSHUAR (AUTORË)

Ky seksion i referohet personave të dyshuar nga policia për kryerjen e një veprë penale dhe të arrestuarve. Policia mbledh të dhëna për të gjithë personat e dyshuar, edhe pse në sistemin e drejtësisë vetëm personat mbi 14 vjeç kanë përgjegjësi penale.

Të dhënat mbi të dyshuarit janë të disagreguara sipas kategorive të veprave penale, gjinisë, grupmoshës dhe shtetësisë. Numri i personave të dyshuar për një vepër penale mund të jetë më i lartë krahasuar me numrin e


veprave penale të evidentuara, sepse në kryerjen e një veprë penale mund të ketë më shumë se një të dyshuar.

Në vitin 2024, janë evidentuar 40.057 persona të dyshuar, 1,4 % më shumë krahasuar me vitin 2023 dhe 4,9 % më shumë krahasuar me vitin 2022.

Nga figura vihet re që, në vitin 2024, qarku i Tiranës dhe Durrësit zënë peshën më të madhe të të dyshuarve ndaj totalit, respektivisht me 38,2 % dhe 11,6 %.

FIG.13

Përqindja e të dyshuarve sipas qarqeve, 2024



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, INSTAT

Të dyshuar sipas veprave penale dhe gjinisë


Nga figura vihet re se, numri gjithsej i autorëve është rritur nga 38,198 në vitin 2022 në 40,057 në vitin 2024, me një rritje prej rreth 4.9 % në periudhën trevjeçare.

Në vitin 2024 janë evidentuar 2.528 femra të dyshuara (6,3 %) dhe 37.529 meshkuj të dyshuar (93,7 %).

Krahasuar me vitin 2023, numri i femrave të dyshuara ka rënë me 5,5 %, ndërsa krahasuar me vitin 2022 është rritur me 16,9 %.

FIG.14

Autorë sipas gjinisë



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, INSTAT

TAB.7

Autorë sipas veprave dhe gjinisë

Vepra penale	2022		2023		2024	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
Vrasje me dashje	37	*	40	*	51	4
Vrasje të mbetura në tentativë	114	*	119	*	108	*
Shkaktim vetvrasje	12	4	14	3	19	4
Kanosja	935	63	1.099	94	1.138	91
Plagosje e rëndë me dashje	196	3	192	*	208	3
Plagosje e lehtë me dashje	1.084	39	1.271	41	1.345	40
Përdhunimi	55	*	52	*	48	*
Abuzime seksuale	115	*	87	*	97	*
Trafikimi i qenieve njerezore	47	*	36	10	78	23
Dhuna në familje (neni 130/a)	1.824	179	1.833	196	2.098	200
Shfrytëzim prostitucioni	122	21	230	34	134	77
Pornografia	100	*	27	*	66	4
Përndjekje	149	11	180	11	204	17
Vjedhje	1.913	83	2.429	103	1.845	111
Vjedhje me dhunë	114	4	105	*	93	*
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	112	10	49	*	44	8
Mashtime	1.007	157	867	149	758	117
Fallsifikim monedhash	53	*	20	*	29	7
Punësim i paligjshëm	126	20	156	28	150	26
Pastrimi i parave	584	43	463	37	435	22
Krime në fushën e drogës	3.606	83	4.017	69	3.267	42
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	5.083	215	5.111	203	5.289	212
Krime kibernetike	34	12	116	13	197	32
Trafikimi i armëve dhe i municionit	1.456	18	1.718	20	1.554	19
Vepra penale të lidhura me organizatat kriminale	484	7	240	*	390	9
Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror	685	23	666	25	500	15
Dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit	613	17	342	14	201	7
Shtrengim ose pengim për të bashkëjetuar ose zgjidhur martesën	16	*	9	*	*	*
Korrupsion	670	12	355	22	324	22
Abuzim detyre	779	41	581	97	523	62
Ndërtim i paligjshëm	1.175	86	1.390	118	1.303	101
Vepra penale kundër mjedisit	632	12	615	13	559	9
Vepra penale të paklasifikuara	12.104	992	12.386	1.362	14.472	1.242
Gjithsej	36.036	2.162	36.815	2.674	37.529	2.528

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

* Vlera të fshehura për arsye të konfidencialitetit


Të dyshuar sipas moshës

Gjatë periudhës 2022-2024, përqindja e personave gjithsej të dyshuar sipas grupmoshave është pothuajse e ngjashme. Në vitin 2024, vihet re se të mitur të dyshuar sipas veprave penale plagosje me dashje, abuzime seksuale, dhuna në familje, përndjekje, vjedhje, mashtrime dhe krime në fushën e drogës janë ulur krahasuar me vitin 2023.


Gjithashtu edhe të dyshuar të rritur sipas veprave penale vrasje të mbetura në tentativë, përdhunimi, shfrytëzim prostitucioni, vjedhje, mashtrime, pastrimi i parave, krime në fushën e drogës, trafikimi i armëve dhe i municionit, kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror, dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit, në vitin 2024 janë ulur krahasuar me vitin parardhës.

FIG.15

Përqindja e personave të dyshuar të mitur, të rritur



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, INSTAT



TAB.8

Autorë sipas veprave penale dhe grupmoshës

Vepra penale	2022		2023		2024	
	Mitur	Rritur	Mitur	Rritur	Mitur	Rritur
Vrasje me dashje	*	38	4	38	6	49
Vrasje të mbetura në tentativë	3	112	*	119	12	96
Shkaktim vetvrasje	*	16	*	17	*	23
Kanosja	14	984	32	1.161	42	1.187
Plagosje e rëndë me dashje	17	182	27	167	19	192
Plagosje e lehtë me dashje	128	995	137	1.175	121	1.264
Përdhunimi	7	48	4	48	5	43
Abuzime seksuale	3	112	4	83	*	95
Trafikimi i qenieve njerezore	3	45	*	46	3	98
Dhuna në familje (neni 130/a)	17	1.986	23	2.006	18	2.280
Shfrytëzim prostitucioni	*	143	*	264	4	207
Pornografia	*	102	4	23	14	56
Përndjekje	*	159	6	185	*	219
Vjedhje	413	1.583	614	1.918	400	1.556
Vjedhje me dhunë	22	96	18	99	14	81
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	*	122	*	51	*	52
Mashtrime	10	1.154	13	1.003	6	869
Fallsifikim monedhash	*	53	*	22	*	36
Punësim i paligjshëm	*	146	3	181	3	173
Pastrimi i parave	4	623	3	497	*	455
Krime në fushën e drogës	147	3.542	161	3.925	117	3.192
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	343	4.955	399	4.915	412	5.089
Krime kibernetike	*	46	7	122	10	219
Trafikimi i armëve dhe i municionit	139	1.335	158	1.580	217	1.356
Vepra penale të lidhura me organizatat kriminale	77	414	*	242	*	399
Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror	24	684	10	681	9	506
Dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit	11	619	*	355	*	207
Shtërngim ose pengim për të bashkëjetuar ose zgjidhur martesën	*	16	*	9	*	*
Korrupsion	8	674	*	377	*	346
Abuzim detyre	*	820	*	677	*	585
Ndërtim i paligjshëm	3	1.258	*	1.508	*	1.403
Vepra penale kundër mjedisit	*	642	3	625	3	565
Vepra penale të paklasifikuara	375	12.721	373	13.365	392	15.322
Gjithsej	1.773	36.425	2.005	37.484	1.835	38.222

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

* Vlera të fshehura për arsye të konfidencialitetit

Të dyshuar sipas shtetësisë

Në vitin 2024 janë evidentuar 1.020 shtetas të huaj të dyshuar, 38,4 % më shumë, krahasuar me vitin 2023 dhe pothuasje dyfishuar, krahasuar me 2022.

Në totalin e personave të dyshuar, të huajt përbëjnë 2,5 % të të dyshuarve. Kjo përqindje ka ardhur në rritje përgjatë tre viteve të fundit.


Të huajt janë të përfshirë më së shumti në vepra penale si: shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, krime në

fushën e drogës, shfrytëzim prostitucioni, vjedhje, mashtrime dhe krime kibernetike.

Krahasuar me vitin 2022, për veprat shfrytëzim prostitucioni, shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor dhe trafikimi i qënieve njerëzore, numri i autorëve të huaj ka pësuar rritje më të madhe.

FIG.16


Persona të dyshuar gjithsej dhe përqindja e të huajve të dyshuar



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, INSTAT

FIG.17

Përqindja e të huajve të dyshuar sipas veprave kryesore



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, INSTAT

1.4 PERSONA TË ARRESTUAR

Gjatë periudhës 2022-2024 vihet re se numri i të arrestuarve ka ardhur duke rënë. Në vitin 2024, numri i personave të arrestuar nga policia është 8.771, duke shënuar rënie me 4,6 %, krahasur me vitin 2023, dhe rënie me 8,1 %, krahasuar me vitin 2022.

Në vitin 2024, numri i të arrestuarve për veprat penale abuzime seksuale, trafikimi i qënieve njerëzore, dhuna në familje dhe organizata kriminale është rritur.

Më shumë se ngjysma e personave të arrestuar (53,8 %) janë për veprat shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor,


krime në fushën e drogës, dhuna në familje dhe trafikimi i armëve dhe i municionit.

Ndërsa numri i autorëve ka pasur luhatje, përqindja e të arrestuarve ka shfaqur një trend të përgjithshëm ulës. Në vitin 2015 shënohet dhe përqindja më e lartë e personave të arrestuar, me 30,1 %.

Ndërkohë viti 2019 shënon përqindjen më të ulët të personave të arrestuar dhe numrin më të lartë të të dyshuarve.

FIG.18

Përqindja e të arrestuarve, 2015-2024



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, INSTAT



TAB.9

Të arrestuar sipas veprave penale

Vepra penale	2022	2023	2024
	Të arrestuar	Të arrestuar	Të arrestuar
Vrasje me dashje	19	20	32
Vrasje të mbetura në tentativë	56	65	60
Shkaktim vetvrasje	8	*	8
Kanosja	61	78	62
Plagosje e rëndë me dashje	103	105	112
Plagosje e lehtë me dashje	55	97	83
Përdhunimi	11	22	13
Abuzime seksuale	31	27	36
Trafikimi i qenieve njerezore	*	4	8
Dhuna në familje (neni 130/a)	682	697	844
Shfrytëzim prostitucioni	27	46	42
Pornografia	*	*	3
Përndjekje	46	43	70
Vjedhje	547	615	514
Vjedhje me dhunë	58	54	58
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	17	*	7
Mashtrime	84	101	89
Fallsifikim monedhash	16	5	4
Punësim i paligjshëm	17	25	10
Pastrimi i parave	101	57	22
Krime në fushën e drogës	1.236	1.349	931
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	2.528	2.316	2.288
Krime kibernetike	*	*	*
Trafikimi i armëve dhe i municionit	656	753	657
Vepra penale të lidhura me organizatat kriminale	125	84	182
Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror	21	19	7
Dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit	273	137	90
Shtrengim ose pengim për të bashkëjetuar ose zgjidhur martesën	3	3	*
Korrupsion	72	40	57
Abuzim detyre	81	58	40
Ndërtim i paligjshëm	35	33	46
Vepra penale kundër mjedisit	44	48	17
Vepra penale të paklasifikuara	2.526	2.291	2.376
Gjithsej	9.539	9.198	8.771

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

* Vlera të fshehura për arsye të konfidencialitetit

2

PROCEDIME PENALE DHE TË PANDEHUR



Kapitulli II

PROCEDIME PENALE DHE TË PANDEHUR

Ky kapitull paraqet të dhëna mbi ecurinë e procedimeve penale në vend, duke përfshirë numrin e procedimeve penale të regjistruara dhe të pandehurit sipas llojit të veprave penale dhe karakteristikave të tyre demografike e juridike.

2.1 PROCEDIME PENALE TË REGJISTRUARA

Procedimi penal i referohet një hetimi penal të filluar nga prokuroria për një vepër penale të dyshuar. Procedimet penale të regjistruara gjatë një viti përfshijnë vetëm rastet e reja të regjistruara në atë periudhë dhe nuk përfshijnë procedimet e mbartura nga vitet e mëparshme apo ato të rifilluara pas pezullimit.

Procedime sipas veprave


Në vitin 2024, prokuroria regjistroi gjithsej 24.921 procedime penale. Krahasuar me vitin 2023, numri i procedimeve penale u rrit me 3,4 %, duke treguar një shtim të rasteve të referuara dhe të hetuara nga organet e ndjekjes penale. Krahasuar me vitin 2022, numri gjithsej i procedimeve të

regjistruara paraqet një rënie prej 3,1 %, çka tregon se, pavarësisht rritjes së shënuar gjatë vitit 2024 në raport me vitin pararendës, niveli i procedimeve penale është më i ulët se ai i vitit 2022.

Analiza sipas llojeve të veprave penale evidenton se një pjesë e konsiderueshme e procedimeve lidhen me veprat kundër pasurisë, veprat kundër personit, si dhe shkeljet që lidhen me narkotikët dhe sigurinë rrugore.

Procedimet penale të regjistruara, të cilat kanë pësuar rritje krahasuar me vitin 2023 janë vrasjet me dashje, pastrim i parave, fallsifikimi i monedhave, përdhunimi, abuzime seksuale, shkaktim vetvrasje, dhuna në familje dhe përndjekja.

Ndërkohë, kanë pësuar ulje, veprat penale si kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror, shtrëngim ose pengim për të bashkëjetuar ose zgjidhur martesën, vjedhje me dhunë, korrupsion, vepra penale kundër mjedisit, punësim i paligjshëm, trafikim i armëve dhe municionit.



TAB.10


Procedime penale të regjistruara sipas veprave penale

Vepra penale	2022	2023	2024
Vrasje me dashje	97	70	113
Vrasje të mbetura në tentativë	35	42	36
Shkaktim vetvrasje	233	224	271
Kanosja	224	224	233
Plagosje e rëndë me dashje	100	105	123
Plagosje e lehtë me dashje	547	559	732
Përdhunimi	53	41	59
Abuzime seksuale	108	83	101
Trafikimi i qenieve njerëzore	11	14	13
Dhuna në familje (neni 130/a)	1.453	1.396	1.656
Shfrytëzim prostitucioni	34	29	21
Pornografia	34	51	78
Përndjekje	164	160	185
Vjedhje	6.094	5.193	5.186
Vjedhje me dhunë	100	94	79
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	79	82	83
Mashtrime	679	666	662
Fallsifikim monedhash	42	23	35
Punësim i paligjshëm	27	20	18
Pastrimi i parave	232	156	249
Krime në fushën e drogës	1.592	1.813	1.721
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	4.072	3.932	4.058
Krime kibernetike	85	107	105
Trafikimi i armëve dhe i municionit	624	644	592
Vepra penale të lidhura me organizatat kriminale	1	0	0
Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror	424	631	423
Dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit	308	171	87
Shtrengim ose pengim për të bashkëjetuar ose zgjidhur martesën	12	14	11
Korrupsion	261	166	140
Abuzim detyre	597	502	473
Ndërtim i paligjshëm	1.125	1.153	1.130
Vepra penale kundër mjedisit	372	343	299
Vepra penale të paklasifikuara	5.889	5.387	5.949
Gjithsej	25.708	24.095	24.921

Burimi: Prokuroria e Përgjithshme

FIG.19

Ndryshimi në përqindje i procedimeve penale, 2024-2023



Burimi: Prokuroria e Përgjithshme, INSTAT

Procedime sipas qarqeve

Në vitin 2024, në totalin e procedimeve penale të regjistruara, në qarkun e Tiranës janë regjistruar rreth 1/3 e procedimeve penale (35,5 %).


Ndërkohë, Durrësi është qarku i dytë me numrin më të lartë (10,4 %).

Gjatë periudhës 3 vjeçare, procedimet penale kanë pësuar ulje, pothuajse në të gjitha qarqet.

Përrashtim bën vetëm qarku Vlorë, Korçë dhe Berat, ku procedimet në vitin 2024 janë rritur krahasuar me vitin 2022.

FIG.20

Procedime penale të regjistruara sipas qarqeve, në %, 2024



Burimi: Prokuroria e Përgjithshme, INSTAT

2.2 TË PANDEHUR SIPAS VEPRAVE PENALE

I pandehur quhet personi të cilit i është atribuar vepra penale përmes aktit të njoftimit të akuzës, i cili përmban dëshmi të mjaftueshme për marrjen e personit si të pandehur. Në numrin e të pandehurve për një vit janë përfshirë të pandehurit që janë gjykuar gjatë vitit referues. Ky seksion përmban të dhëna për të pandehurit sipas gjinisë, veprave penale, grupmoshës dhe qarqeve.

Të pandehur sipas veprave

Në vitin 2024, janë regjistruar gjithsej 13.167 persona të pandehur, duke shënuar një rënie me 5,7 %, krahasuar me vitin 2023, dhe një rënie me 19,0 %, krahasuar me vitin 2022. Vihet re që në pjesën më të madhe të veprave penale, në vitin 2024, numri i të pandehurve ka rënë, krahasuar me vitin 2023.

Në krime ekonomike dhe kufitare vihet re një ulje e ndjeshme e të pandehurve, ku rënia më e madhe është regjistruar te punësimi i paligjshëm (-66.7 %), kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror (-64.7 %) dhe dhënia e ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit (-59.2 %).


Po ashtu, kanë rënë trafikimi i qenieve njerëzore (-57.1 %), ndërtimi i paligjshëm (-33.2 %), korrupsioni (-33.1 %) dhe pastrimi i parave (-36.0 %).

Në grupin e veprave që kanë shënuar rritje, dominojnë veprat si përndjekja (+26.0 %), plagosja e rëndë me dashje (+18.6 %) dhe përdhunimi (+18.5 %).

Po ashtu, janë rritur ndjeshëm edhe të pandehurit që lidhen me krimet në fushën e drogës (+13.8 %), dhunën në familje (+13.1 %) dhe abuzimin e detyrës (+9.9 %).

FIG.21

Ndryshimi në përqindje i të pandehurve, 2024-2023



Burimi: Prokuroria e Përgjithshme, INSTAT

Të pandehur sipas gjinisë

Përgjatë tre viteve të fundit, numri gjithsej i të pandehurve meshkuj dhe femra ka shënuar rënie. Megjithatë, në vitin 2024 vihet re një ndryshim gjinor në shpërndarjen sipas veprave penale.

Të pandehurit meshkuj kanë pësuar ulje për veprat penale si: vrasje me dashje, plagosje e lehtë me dashje, vjedhje, punësim i paligjshëm, pastrim parash, kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror, dhënie ndihme për kalim të paligjshëm të kufirit shtetëror, korrupsion, ndërtim i paligjshëm dhe vepra penale kundër mjedisit. Ndërsa është vërejtur rritje e numrit të të pandehurve meshkuj për veprat penale: plagosje e rëndë me dashje, përdhunim, dhunë në familje, përndjekje, krime në fushën e drogës, shkelje

të rregullave të qarkullimit rrugor dhe abuzim detyre, krahasuar me vitin 2023.

Në vitin 2024, personat e pandehur femra kanë shënuar ulje për veprat penale si: plagosja e lehtë me dashje, përdhunimi, trafikimi i qenieve njerëzore, pastrimi i parave, korrupsion, krime në fushën e drogës, ndërtim i paligjshëm, trafikimi i armëve dhe municionit krahasuar me vitin 2023.

Ndërkohë, në të njëjtin vit, personat e pandehur femra kanë shënuar rritje për veprat penale: vrasje me dashje, plagosje e rëndë me dashje, dhunë në familje, vjedhje, mashtrim, shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor dhe abuzim detyre, në krahasim me vitin paraardhës.

TAB.11
Të pandehur sipas veprave penale dhe gjinisë

Vepra penale	2022		2023		2024	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
Vrasje me dashje	0,7%	0,5%	0,6%	0,3%	0,5%	0,7%
Vrasje të mbetura në tentativë	0,2%	0,0%	0,4%	0,1%	0,4%	0,0%
Shkaktim vetvrasje	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%
Kanosja	0,4%	0,4%	0,4%	0,3%	0,4%	0,4%
Plagosje e rëndë me dashje	0,6%	0,5%	0,8%	0,1%	0,9%	1,0%
Plagosje e lehtë me dashje	2,7%	1,8%	2,6%	1,2%	2,2%	1,1%
Përdhunimi	0,4%	0,2%	0,2%	0,4%	0,3%	0,0%
Abuzime seksuale	0,5%	0,0%	0,4%	0,1%	0,4%	0,1%
Trafikimi i qenieve njerëzore	0,0%	0,0%	0,0%	0,5%	0,0%	0,1%
Dhuna në familje (neni 130/a)	8,7%	10,2%	8,4%	7,6%	10,1%	9,7%
Shfrytëzim prostitucioni	0,1%	0,8%	0,1%	1,1%	0,1%	0,6%
Pornografia	0,0%	0,1%	0,0%	0,0%	0,0%	0,1%
Përndjekje	0,7%	0,4%	0,7%	0,8%	1,0%	1,0%
Vjedhje	6,5%	5,2%	7,1%	6,2%	7,1%	7,4%
Vjedhje me dhunë	0,4%	0,2%	0,5%	0,3%	0,6%	0,1%
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	0,3%	1,3%	0,3%	1,1%	0,3%	1,4%
Mashtrime	1,5%	4,8%	1,9%	4,7%	2,0%	8,4%
Fallsifikim monedhash	0,2%	0,0%	0,1%	0,1%	0,1%	0,1%
Punësim i paligjshëm	0,0%	0,0%	0,1%	0,1%	0,0%	0,1%
Pastrimi i parave	0,3%	0,7%	0,3%	0,7%	0,2%	0,3%
Krime në fushën e drogës	10,5%	4,7%	9,3%	5,5%	11,4%	3,9%
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	24,4%	11,1%	24,7%	10,1%	27,0%	11,5%
Krime kibernetike	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,1%

Trafikimi i armëve dhe i municionit	3,6%	1,4%	3,8%	1,5%	4,0%	0,6%
Vepra penale të lidhura me organizatat kriminale	0,1%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%
Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror	2,7%	1,6%	4,8%	1,8%	1,8%	0,7%
Dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit	2,4%	2,3%	2,3%	1,5%	1,0%	0,8%
Shtërngim ose pengim për të bashkëjetuar ose zgjidhur martesën	0,0%	0,0%	0,0%	0,1%	0,0%	0,0%
Korrupsion	1,3%	0,1%	1,2%	1,4%	0,9%	0,7%
Abuzim detyre	2,0%	4,1%	1,6%	5,0%	1,8%	6,0%
Ndërtim i paligjshëm	5,5%	8,4%	4,6%	8,4%	3,4%	4,2%
Vepra penale kundër mjedisit	1,0%	0,2%	0,7%	0,7%	0,6%	0,4%
Gjithsej	15.393	853	13.223	740	12.455	712

Burimi: Prokuroria e Përgjithshme

* Vlera të fshehura për arsye të konfidencialitetit

Të pandehur sipas moshës

Në 2024, janë regjistruar 503 të pandehur të mitur (14-17 vjeç) dhe 12.664 të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç). Gjatë periudhës 2022–2024, numri i të pandehurve të mitur është rritur me 5,7 %, ndërsa numri i të pandehurve të rritur është ulur me 19,7 %.

Të dhënat e paraqitura në grafik tregojnë shpërndarjen në përqindje të të pandehurve sipas grupmoshës, të


ndarë në të mitur dhe të rritur, për periudhën trevjeçare 2022–2024.

Pjesa më e madhe e të pandehurve janë të rritur, ndërsa të miturit përbëjnë një përqindje shumë të vogël të totalit.

Megjithatë, kjo përqindje ka shënuar një rritje graduale nga viti në vit.

FIG.22

Të pandehur gjithsej sipas grupmoshës



Burimi: Prokuroria e Përgjithshme, INSTAT

Gjatë periudhës trevjeçare, numri i të pandehurve të mitur është më i lartë për veprat penale që lidhen me shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor dhe vjedhjen. Ndërkohë, numri i të pandehurve të rritur rezulton

më i lartë për veprat penale që lidhen me dhunën në familje, vjedhjen, krimet në fushën e drogës, shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor, si dhe trafikimin e armëve dhe municionit.

TAB.12

Të pandehur sipas llojit të veprave dhe grupmoshës

Vepra penale	2022		2023		2024	
	Mitur	Rritur	Mitur	Rritur	Mitur	Rritur
Vrasje me dashje	*	112	7	76	7	66
Vrasje të mbetura në tentativë	*	36	*	57	*	52
Shkaktim vetvrasje	*	7	*	3	*	6
Kanosja	*	67	*	51	*	48
Plagosje e rëndë me dashje	7	89	8	94	10	111
Plagosje e lehtë me dashje	20	408	25	328	6	271
Përdhunimi	3	55	*	26	4	28
Abuzime seksuale	*	72	*	50	*	50
Trafikimi i qenieve njerëzore	*	3	*	6	*	3
Dhuna në familje (neni 130/a)	13	1.406	5	1.167	17	1.309
Shfrytëzim prostitucioni	*	20	*	25	*	17
Pornografia	4	*	*	4	3	*
Përndjekje	*	117	*	104	*	130
Vjedhje	107	934	144	840	106	834
Vjedhje me dhunë	5	65	9	56	6	69
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	*	62	*	52	*	53
Mashtrime	*	265	*	292	6	303
Fallsifikim monedhash	4	23	*	13	*	14
Punësim i paligjshëm	*	6	*	15	*	5
Pastrimi i parave	*	58	*	50	*	32
Krime në fushën e drogës	37	1.613	31	1.237	34	1.409
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	145	3.703	154	3.192	209	3.230
Krime kibernetike	*	*	*	*	*	3
Trafikimi i armëve dhe i municionit	58	511	39	478	36	472
Vepra penale të lidhura me organizatat kriminale	*	8	*	*	*	*
Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror	3	432	*	647	*	228
Dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit	5	391	*	310	*	125
Shtërngim ose pengim për të bashkëjetuar ose zgjidhur martesën	*	*	*	7	*	4
Korrupsion	*	197	*	172	*	115
Abuzim detyre	6	338	*	243	*	267
Ndërtim i paligjshëm	3	916	*	674	*	451
Vepra penale kundër mjedisit	*	158	*	94	*	83
Vepra penale të paklasifikuara	52	3.693	27	3.141	50	2.875
Gjithsej	476	15.770	457	13.506	503	12.664

Burimi: Prokuroria e Përgjithshme

* Vlera të fshehura për arsye të konfidencialitetit


Të pandehur sipas qarqeve

Në figurën e mëposhtme paraqitet numri i të pandehurve sipas qarikut. Qarqet Tiranë, Durrës dhe Elbasan kanë përqindjen më të lartë të të pandehurve, përkatësisht 31,2 %, 16,5 % dhe 13,0 % të totalit.

Ndërkohë, qarqet Gjirokastrë dhe Kukës paraqesin përqindjen më të ulët të të pandehurve, përkatësisht 0,8 % dhe 1,7 %. Në përgjithësi, vihet re një përqendrim më i lartë i të pandehurve në qarqet më të urbanizuara të vendit.

FIG.23

Të pandehur sipas qarqeve, viti 2024



Burimi: Prokuroria e Përgjithshme, INSTAT



3

TË DËNUAR



Kapitulli III

TË DËNUAR

Ky kapitull paraqet të dhëna për personat e dënuar në Gjykatat e Shkallës së Parë sipas veprave penale, gjinisë, grupmoshës dhe masave të dënimit. Burimi i të dhënave është Ministria e Drejtësisë.

3.1 TË DËNUAR DHE TË PAFAJSHËM

Person i dënuar konsiderohet personi i shpallur fajtor për një vepër penale kundër ligjit. Në numrin e personave të dënuar për një vit përfshihen personat e dënuar me gjobë dhe të dënuar me burgim gjatë vitit referues. Ky numër përfshin vetëm persona të dënuar në gjykatat e shkallës së parë.

Person i pafajshëm është ai individ ndaj të cilit është zhvilluar një procedurë penale, por që nuk është shpallur fajtor nga gjykata për veprën penale për të cilën është akuzuar.

Tabela paraqet numrin e personave të dënuar ose të pafajshëm sipas moshës. Në vitin 2024, të dënuar gjithsej janë 8.907 persona. Krahasuar me vitin 2023, numri i të dënuarve ka mbetur pothuajse i pandryshuar (+0,6 %). Ndërkohë, krahasuar me vitin 2022, numri i të dënuarve ka rënë me 22 %. Sipas ndarjes moshore, përgjatë 3 viteve, shumica e të dënuarve janë të rritur (98 %).

Përqindja e të pafajshmëve mbetet e ulët në raport me numrin e përgjithshëm të të gjykuarve, por në vitin 2024 shënohet një rritje e lehtë, pas rënies në 2023.

Të dënuar sipas veprave penale dhe gjinisë

Tabela paraqet numrin e personave të dënuar të rritur, sipas veprës penale dhe gjinisë, për periudhën 2022-2024.

Në vitin 2024, numri i personave të dënuar të rritur është ulur me 22,1 %, krahasuar me vitin 2022 dhe është rritur me 0,7 % krahasuar me vitin 2023.

Në vitin 2024, të dënuarit për veprat penale si: plagosja e lehtë me dashje, vjedhje duke shpërdoruar detyrën, kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror, dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit, korrupsion, abuzim detyre, ndërtim i paligjshëm, kanë shënuar ulje, krahasuar me vitin paraardhës.

Gjatë tre viteve të fundit, meshkujt përbëjnë rreth 94–95% të të dënuarve çdo vit dhe janë të përfshirë pothuajse në të gjitha kategoritë e veprave penale. Ndërkohë, femrat përbëjnë afërsisht vetëm 5% të autorëve të dënuar dhe kryesisht janë të përfshira në vepra penale si dhuna në familje, mashtrimi dhe abuzimi me detyrën, ndërtimi i paligjshëm dhe shfrytëzimi i prostitucionit.

Për veprat penale si Plagosja e lehtë me dashje dhe Ndërtimi i paligjshëm, numri i femrave të dënuara ka shënuar rënie krahasuar me vitin 2023. Ndërkohë, për veprat penale si Shfrytëzimi i prostitucionit, Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor dhe Vjedhja duke shpërdoruar detyrën, vërehet një rritje e numrit të femrave të dënuara. Për veprat e tjera penale, numri i femrave të dënuara ka mbetur pothuajse në të njëjtat nivele.

TAB.13

Të dënuar dhe të pafajshëm

	2022		2023		2024	
Grupmosha	Rritur	Gjithsej	Rritur	Gjithsej	Rritur	Gjithsej
Të dënuar	11.203	11.422	8.670	8.856	8.730	8.907
Të pafajshëm	379	392	307	309	362	363

Burimi: Ministria e Drejtësisë

TAB.14

Të dënuar të rritur sipas veprave penale dhe gjinisë

Vepra penale	2022		2023		2024	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
Vrasje me dashje	0,9%	0,5%	0,9%	0,2%	1,1%	0,7%
Shkaktim vetvrasje	0,0%	0,2%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%
Kanosja	0,4%	0,2%	0,2%	0,0%	0,1%	0,2%
Plagosje e rëndë me dashje	0,4%	0,0%	0,5%	0,4%	0,6%	0,4%
Plagosje e lehtë me dashje	1,8%	0,5%	1,8%	2,4%	0,8%	1,1%
Përdhunimi	0,3%	0,2%	0,3%	0,0%	0,2%	0,2%
Abuzime seksuale	0,3%	0,0%	0,3%	0,0%	0,4%	0,0%
Trafikimi i qenieve njerëzore	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,2%
Dhuna në familje (neni 130/a)	9,4%	7,8%	9,6%	8,9%	10,4%	9,8%
Shfrytëzim prostitucioni	0,1%	0,5%	0,0%	0,0%	0,0%	3,7%
Pornografia	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%
Përndjekje	0,7%	0,0%	0,6%	0,2%	0,8%	1,1%
Vjedhje	6,1%	4,9%	6,1%	5,7%	7,3%	5,6%
Vjedhje me dhunë	0,6%	0,2%	0,6%	0,4%	0,6%	0,0%
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	0,3%	0,7%	0,4%	1,1%	0,2%	2,2%
Mashtrime	1,4%	4,1%	1,5%	4,6%	1,8%	5,0%
Fallsifikim monedhash	0,2%	0,4%	0,1%	0,0%	0,1%	0,2%
Punësim i paligjshëm	0,0%	0,0%	0,1%	0,2%	0,0%	0,0%
Pastrimi i parave	0,3%	0,5%	0,2%	0,0%	0,1%	0,2%
Krime në fushën e drogës	8,3%	4,1%	8,6%	2,4%	11,0%	6,7%
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	19,8%	6,5%	21,2%	7,4%	31,7%	12,1%
Krime kibernetike	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%
Trafikimi i armëve dhe i municionit	4,0%	0,4%	3,8%	1,1%	4,1%	1,1%
Organizata kriminale	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,2%	0,2%
Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror	3,0%	2,1%	3,3%	0,7%	0,9%	1,3%
Dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit	2,4%	2,6%	2,8%	0,7%	1,5%	0,2%
Shtërngim ose pengim për të bashkëjetuar ose zgjidhur martesën	0,1%	0,0%	0,2%	0,0%	0,2%	0,0%
Korrupsion	1,4%	1,8%	2,0%	2,0%	1,6%	1,1%
Abuzim detyre	1,0%	3,2%	1,4%	3,5%	0,8%	4,3%
Ndërtim i paligjshëm	6,7%	8,8%	5,7%	11,8%	3,6%	3,7%
Vepra penale kundër mjedisit	0,8%	0,4%	0,6%	0,4%	0,4%	0,7%
Gjithsej	10.636	567	8.211	459	8.269	461


Burimi: Ministria e Drejtësisë

Figura e mëposhtme paraqet shpërndarjen e të dënuarve për femrat dhe meshkujt, sipas veprave penale që zënë peshën më të madhe në secilin grup.

Analiza është realizuar veçmas për femrat dhe për meshkujt, duke evidentuar veprat penale kryesore që kontribuojnë më shumë në totalin e të dënuarve përkatës.

FIG.24

Përqindja e të dënuarëve të rritur sipas veprave kryesore dhe gjinisë, viti 2024



Burimi: Ministria e Drejtësisë, INSTAT

Të dënuar sipas veprave penale dhe moshës

Në vitin 2024, rezultojnë 8.730 të dënuar të rritur dhe 177 të dënuar të mitur.


Numri i të dënuarve të mitur ka shënuar rënie, përkatësisht me 4,8 % dhe 19,2 %, krahasur me 2023 dhe 2022. Veprat ku të miturit janë më të përfaqësuar janë kryesisht: plagosje e rëndë me dashje, plagosje e lehtë, vjedhje, dhe vjedhje me dhunë.

Në veprat penale si vrasje me dashje, vjedhje dhe shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, numri i të dënuarve të mitur është rritur, krahasuar me 2023.

Sic vihet re dhe nga figura, shumica e të dënuarve janë të rritur, ndërkohë pjesëmarrja e të miturve mbetet relativisht e vogël në të gjitha veprat, në shumicën e rasteve nën 3 %.

Veprat ku përfshirja e të miturve është më e lartë janë: plagosje e rëndë me dashje me 10.5 %, vjedhje me 9.4 % dhe vrasje me dashje me 5.2 %.

FIG.25
Përqindja e të dënuarve gjithsej sipas veprave kryesore dhe grupmoshës, viti 2024



Burimi: Ministria e Drejtësisë, INSTAT

TAB.15

Të dënuar gjithsej sipas veprave penale dhe grupmoshës

Vepra penale	2022		2023		2024	
	Rritur	Mitur	Rritur	Mitur	Rritur	Mitur
Vrasje me dashje	0,9%	1,8%	0,9%	0,5%	1,1%	2,8%
Shkaktim vetvrasje	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%
Kanosja	0,4%	0,0%	0,2%	0,0%	0,1%	0,0%
Plagosje e rëndë me dashje	0,4%	2,3%	0,5%	2,7%	0,6%	3,4%
Plagosje e lehtë me dashje	1,7%	0,9%	1,8%	3,8%	0,8%	0,6%
Përdhunimi	0,3%	1,4%	0,2%	0,0%	0,2%	0,0%
Abuzime seksuale	0,3%	0,0%	0,3%	0,5%	0,4%	0,6%
Trafikimi i qenieve njerëzore	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%
Dhuna në familje (neni 130/a)	9,3%	2,7%	9,5%	1,6%	10,3%	1,7%
Shfrytëzim prostitucioni	0,1%	0,0%	0,0%	0,0%	0,2%	0,0%
Pornografia	0,0%	2,3%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%
Përndjekje	0,7%	0,9%	0,5%	0,5%	0,8%	0,0%
Vjedhje	6,1%	21,5%	6,0%	23,1%	7,2%	36,7%
Vjedhje me dhunë	0,6%	3,7%	0,6%	2,2%	0,5%	4,5%
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	0,4%	0,0%	0,5%	0,0%	0,3%	0,0%
Mashtrime	1,6%	0,0%	1,6%	0,5%	1,9%	0,6%
Fallsifikim monedhash	0,2%	0,0%	0,1%	1,6%	0,1%	0,0%
Punësim i paligjshëm	0,0%	0,0%	0,1%	0,0%	0,0%	0,0%
Pastrimi i parave	0,3%	2,3%	0,2%	0,0%	0,1%	0,0%
Krime në fushën e drogës	8,1%	9,6%	8,3%	9,1%	10,8%	10,7%
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	19,1%	16,4%	20,4%	11,8%	30,7%	24,3%
Krime kibernetike	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%
Trafikimi i armëve dhe i municionit	3,8%	0,0%	3,7%	7,5%	3,9%	6,2%
Vepra penale të lidhura me organizatat kriminale	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,2%	0,0%
Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror	3,0%	0,5%	3,1%	0,0%	1,0%	0,6%
Dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit	2,4%	1,8%	2,6%	1,1%	1,4%	0,0%
Shtërngim ose pengim për të bashkëjetuar ose zgjidhur martesën	0,1%	0,0%	0,2%	0,0%	0,2%	0,0%
Korrupsion	1,4%	0,0%	2,0%	0,5%	1,6%	0,0%
Abuzim detyre	1,1%	0,0%	1,5%	0,0%	1,0%	0,0%
Ndërtim i paligjshëm	6,8%	0,9%	6,0%	0,0%	3,6%	0,0%
Vepra penale kundër mjedisit	0,8%	0,0%	0,6%	0,0%	0,4%	0,0%
Gjithsej	11.203	219	8.670	186	8.730	177

Burimi: Ministria e Drejtësisë

* Vlera të fshehura për arsye të konfidencialitetit

3.2 MASAT E DËNIMIT TË PERSONAVE TË DËNUAR DHE DËNIMET ALTERNATIVE

Masat e dënimit

Masat e dënimit përfaqësojnë llojin dhe kohëzgjatjen e sanksionit penal të vendosur ndaj personave të dënuar nga gjykatat, në varësi të rëndësisë së veprës penale.

Këto masa përfshijnë dënimet me gjobë, dënimet me burgim afatshkurtër (deri në 2 vjet), afatmesëm (2-10 vjet), si dhe afatgjata (mbi 10 vjet deri në burgim të përjetshëm).

Figura paraqet shpërndarjen në përqindje të dënimeve, duke përfshirë disa kategori dënimesh, nga ato “Me gjobë” e deri te “Burgim i përjetshëm”, sipas kohëzgjatjes së tyre.

Dënimet “deri në 2 vjet” përbëjnë pjesën më të madhe të rasteve në të gjitha vitet dhe kanë shënuar një rritje të dukshme, nga 59.9 % në vitin 2022, në 71.4 % në vitin 2024. Ndërkohë, dënimet me gjobë kanë pësuar një rënie të konsiderueshme, nga 21.0 % në vitin 2022 në vetëm 7.4 % në vitin 2024.


Dënimet nga 2 deri në 5 vjet kanë mbetur pothuajse të pandryshuara gjatë periudhës, duke luhatur rreth 14-15 %, përgjatë 3 viteve të fundit. Sa i përket dënimeve mbi 10 vjet, ato përbëjnë një përqindje shumë të vogël, respektivisht nën 1 % dhe nuk paraqesin ndryshime të ndjeshme gjatë viteve.

TAB.16
Të dënuar sipas masave të dënimit

Viti	Masat e dënimit							Të dënuar
	Me gjobë	Deri në 2 vjet	2 - 5 vjet	5 - 10 vjet	10 - 25 vjet	25 -35 vjet	Burgim i përjetshëm	
2022	1.568	4.473	1.135	209	55	14	10	7.464
2023	794	2.798	702	238	40	8	11	4.591
2024	399	3.836	776	291	47	19	5	5.373

Burimi: Ministria e Drejtësisë

FIG.26
Përqindja e personave të dënuar sipas masave të dënimit



Burimi: Ministria e Drejtësisë, INSTAT

Dënimet alternative

Dënimet alternative janë masa ndëshkuese që përdoren si zëvendësim ose në vend të dënimit me burgim, duke synuar të reduktojnë vuajtjen e plotë të burgimit dhe të favorizojnë rehabilitimin dhe rikthimin e personit në shoqëri.

Përgjatë tre viteve vihet re se dënimet alternative më të zbatuara janë pezullimi i ekzekutimit të vendimit

me burgim dhe vënia në provë, dënimet me gjobë, detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik.


Figura pasqyron peshën që zënë dënimet alternative në raport me numrin total të dënimeve alternative. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë zë peshën më të madhe ndër të gjitha format alternative, me 77,4%.

TAB.17
Të dënuar sipas dënimeve alternative

Dënime alternative	2022	2023	2024
Dënimi me gjobë	1.568	794	399
Heqja e së drejtës të ushtrimit të një profesioni ose të një veprimtarie	16	*	22
Gjysmëliria	16	12	6
Qëndrimi në shtëpi	124	58	43
Detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik	449	402	370
Përmbushja e detyrimeve të caktuara	12	*	12
Masat mjekësore dhe edukuese	23	5	13
Lirimi me kusht	3	11	25
Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë	3.315	3.763	3.043
Gjithsej	5.526	5.047	3.933

Burimi: Ministria e Drejtësisë
* Vlera të fshehura për arsye të konfidencialitetit

FIG.27
Dënimet alternative, 2024




Burimi: Ministria e Drejtësisë, INSTAT



4

PERSONA TË BURGOSUR



Kapitulli IV

PERSONA TË BURGOSUR

Ky kapitull paraqet të dhëna mbi personat e burgosur sipas veprës penale për të cilën janë dënuar, grupmoshës, nivelit arsimor dhe shtetësisë, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

Ndryshe nga kapitujt e tjerë, kategoritë e veprave penale të paraqitura në këtë kapitull nuk janë të krahasueshme me kategoritë dhe nënkategoritë e përdorura më parë. Burimi i të dhënave është Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

4.1 TË BURGOSUR

Në këtë seksion paraqiten të dhëna për të burgosurit sipas veprave penale. Të dhënat paraqesin numrin gjithsej të të burgosurve në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale çdo fund viti dhe jo sa prej tyre kanë hyrë në këto institucione në një datë të caktuar.

Prandaj numri i personave të burgosur për një vepër penale specifike do të ndikohet nga koha e qëndrimit të të burgosurve në këto institucione.

Të burgosur sipas veprave penale

Në vitin 2024, numri i personave të burgosur gjithsej është 4.491, duke shënuar ulje me 13,1 % krahasuar me vitin 2023, dhe rënie me 9,2 % krahasuar me vitin 2022.

Në vitin 2024, pothuajse në të gjitha kategoritë e veprave penale është evidentuar një ulje e numrit të të burgosurve krahasuar me vitin paraardhës. Të burgosur për krime në fushën e drogës përbëjnë grupin më të madh të të burgosurve në vitin 2024 (30,8 %). Kjo kategori ka shënuar një ulje prej 10,3 % krahasuar me vitin 2023. Ndërkohë, të burgosurit për vrasje përbëjnë grupin e dytë me 19,1 %, ndaj totalit të të burgosurve në vitin 2024, pasuar nga të burgosurit për vjedhje (14,5 %).

TAB.18

Të burgosur sipas veprave penale dhe gjinisë, në fund të vitit

Vepra penale	2022		2023		2024	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
Vjedhje e pasurisë	725	8	742	10	640	10
Vrasje	929	15	939	15	843	13
Plagosje	96	*	100	*	80	*
Marrëdhënie seksuale me dhunë	44	*	41	*	21	*
Krime në fushën e drogës	1.366	11	1.525	14	1.367	14
Organizata kriminale	78	*	71	*	85	*
Mashtrime	108	9	122	7	96	6
Shfrytëzim prostitucioni	38	3	40	6	19	8
Trafikim qëniesh njerëzore	19	*	4	*	4	*
Pastrim i produkteve të veprës penale	8	*	7	*	*	*
Korrupsion	62	*	127	*	95	*
Të tjera	1.408	14	1.375	20	1.164	23
Gjithsej	4.881	63	5.093	76	4.414	77

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

* Vlera të fshehura për arsye të konfidencialitetit

Të burgosur sipas qarqeve, grupmoshave dhe shtetësisë

Pjesa më e madhe e personave të burgosur, në institucionet e privimit të lirisë, i përket moshës madhore (mbi 18 vjeç), duke përbërë grupin dominues të popullsisë së burgjeve në të treja vitet, në të gjitha qarqet.

Në vitin 2024, janë 27 të mitur të burgosur dhe 4.464 të burgosur të rritur. Krahasuar me vitin 2023, numri i të

rriturve të burgosur është ulur me 13,3 % dhe numri i të miturve është rritur me 35,0 %. Qarku i Tiranës dhe Fierit ka numrin më të madh të burgosurve, përgjatë tre viteve.

Grupmosha me numrin më të madh të të burgosurve është 21-29 vjeç, për të tre vitet, pasuar nga grupmosha 30-39 vjeç.

TAB.19


Të burgosur sipas qarkut dhe grupmoshës, në fund të vitit

Qarku	2022		2023		2024	
	14-17	18+	14-17	18+	14-17	18+
Berat	*	167	*	181	*	150
Dibër	*	219	*	220	*	160
Durrës	*	520	*	574	*	473
Elbasan	*	362	4	412	4	416
Fier	*	703	*	705	*	565
Gjirokastrë	*	146	*	162	*	177
Korçë	*	502	3	485	*	419
Kukës	*	218	*	170	*	145
Lezhë	3	290	*	327	*	268
Shkodër	*	392	6	382	4	353
Tiranë	*	928	4	969	14	741
Vlorë	*	358	*	436	*	454
Të huaj	*	123	*	126	*	143
Gjithsej	16	4.928	20	5.149	27	4.464

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
* Vlera të fshehura për arsye të konfidentalitetit

FIG.28

Përqindja e të burgosurve sipas grupmoshës



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, INSTAT

Nga figura 29 vihet re se, pjesa më e madhe e personave të privuar nga liria, si meshkuj ashtu edhe femra, i përketin moshës së rritur mbi 30 vjeç, ndërsa përfaqësimi i të rinjve nën 21 vjeç mbetet i ulët në të dy gjinitë.

Lidhur me gratë e burgosura, përfaqësimin më të lartë kanë grupmoshat 30–39 vjeç dhe 40–49 vjeç, respektivisht me 27,3 % secila grupmoshë. Nga të dhënat rezulton se 9,1 % e femrave të burgosura i përket grupmoshës 18–20 vjeç.


Në rastin e burrave, 65,2 % e të burgosurve janë të moshës 30 vjeç e lart. Grupmosha 21–29 vjeç përbën përqindjen

më të lartë, me 30,4 % të meshkujve të burgosur. Ndërkohë, vetëm 3,8 % e meshkujve të burgosur i përketin grupmoshës 18–20 vjeç.

Gjatë periudhës 2022–2024, numrin më të madh të personave të burgosur në institucionet e privimit të lirisë në Shqipëri e përbëjnë shtetasit shqiptarë. Ndërkohë, numri i shtetasve të huaj në burgje ka pësuar një rritje të lehtë (nga 2,4 % në 2022 në 3,0 % në 2024), ndërsa përqindja e shtetasve shqiptarë është zvogëluar në mënyrë proporcionale.

FIG.29


Përqindja e femrave dhe meshkujve sipas grupmoshës, 2024



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, INSTAT

FIG.30

Përqindja e të burgosurve sipas shtetësisë



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, INSTAT


Të burgosur sipas nivelit arsimor

Gjatë periudhës 2022–2024, personat me arsim 9-vjeçar përbëjnë grupin më të madh të të dënuarve në burgje, si për meshkujt ashtu edhe për femrat.

Në vitin 2024, në institucionet e privimit të lirisë, personat me arsim të lartë, përbëjnë 6,4 % të totalit të të burgosurve.

FIG. 31

Përqindja e të burgosurve sipas nivelit arsimor dhe gjinisë, në fund të vitit



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
* Vlera të fshehura për arsye të konfidentalitetit

4.2 TË DËNUAR ME BURG DHE TË PARABURGOSUR

Të dënuar me burg i referohet personave të dënuar me burg me vendim përfundimtar nga gjykatat. Të paraburgosurit i referohen personave ndaj të cilëve është marrë masa arrest me burg.

Ata mbahen në institucionet e paraburgimit dhe në burgje dhe numri i tyre reflekton gjëndjen e tyre deri në datën 31 dhjetor të vitit të dhënë.

Të dënuar dhe të paraburgosur sipas qarkut dhe gjinisë

Në vitin 2024, në burgje janë 2.778 të paraburgosur dhe 1.713 të dënuar me burg.

Nga tabela e mëposhtme vihet re se, meshkujt përbëjnë mbi 98 % të popullsisë së burgosur në të gjitha vitet, ndërsa femrat e burgosura mbeten në numër të ulët, por me trend rritës (nga 1,3 % në vitin 2022 në 1,7 % në vitin 2024).

TAB.20

Të paraburgosur dhe të dënuar me burg sipas gjinisë, në fund të vitit

	2022		2023		2024	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
Të paraburgosur	2.237	26	2.935	42	2.725	53
Të dënuar me burg	2.644	37	2.158	34	1.689	24
Të burgosur	4.881	63	5.093	76	4.414	77

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve


Figura 32 paraqet përqindjen e personave të paraburgosur në raport me totalin e të burgosurve sipas gjinisë. Për të dyja gjinitë vihet re një tendencë rritëse e përqindjes së të paraburgosurve. Në vitin 2024, përqindja e të paraburgosurve meshkuj shënon një rritje prej 4,1 pikë përqindje, dhe

përqindja e të paraburgosurve femra shënon një rritje prej 13,6 pikë përqindje krahasuar me vitin 2023.

Qarku i Tiranës dhe Fierit ka numrin më të madh të të dënuarve me burg, ndërkohë qarku i Tiranës dhe Vlorës mban numrin më të lartë të të paraburgosurve, për vitin 2024.

FIG.32

Përqindja e të paraburgosurve sipas gjinisë, në fund të vitit



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, INSTAT

TAB.21

Të dënuar dhe të paraburgosur sipas qarkut, në fund të vitit, 2024

Qarku	2024		
	Të dënuar	Të paraburgosur	Të burgosur gjithsej
Berat	51	99	150
Dibër	68	92	160
Durrës	182	292	474
Elbasan	153	267	420
Fier	272	294	566
Gjirokastrë	60	117	177
Korçë	149	272	421
Kukës	46	99	145
Lezhë	114	154	268
Shkodër	135	222	357
Tiranë	314	441	755
Vlorë	141	314	455
Të huaj	28	115	143
Shqipëria	1.713	2.778	4.491

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

4.3 PERSONELI DHE KAPACITETI I BURGJEVE

Personeli i burgjeve përbëhet nga punonjësit që sigurojnë funksionimin, mbikëqyrjen, administrimin dhe rehabilitimin e të dënuarve në institucionet e privimit të lirisë. Ndërsa, kapaciteti i burgjeve paraqet numrin maksimal të personave që një institucion mund të strehojë sipas kushteve ekzistuese.

Kapaciteti i burgjeve

Sipas të dhënave në tabelë, në vitin 2024 kapaciteti i institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale për të rritur në vend është rritur me 1,6 %, krahasuar me vitin 2022. Ndërkohë, kapaciteti i institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale për të miturit në vend ka mbetur i pandryshuar.

Shkalla e zënies së kapacitetit matet si përqindja e numrit të personave aktualisht të mbajtur në burg në raport me kapacitetin zyrtar të burgut. Kjo shifër jep një tregues të ngarkesës së burgut dhe përdoret për të vlerësuar nëse një burg është i mbipopulluar, i plotësuar ose në kapacitet të lirë.

Një shkallë zënieje nën 100% tregon që burgu nuk është mbipopulluar, ndërsa një shkallë mbi 100% do të tregonte mbipopullim.


Nga figura vihet re se, përgjatë viteve 2022-2024, shifrat e paraqitura tregojnë se burgjet nuk janë të mbipopulluar. Në vitin 2024, burgu është i zënë në 78,1% të kapacitetit zyrtar, që është një nivel relativisht i ulët ngarkese, krahasuar me vitet e tjera.

TAB.22
Kapaciteti i burgjeve sipas grupmoshës dhe gjinisë, gjatë vitit

		2022	2023	2024
Kapaciteti i burgjeve	Të rritur	5.617	5.687	5.707
	Të mitur	40	40	40
	Gjithsej	5.657	5.727	5.747
	Meshkuj	5.557	5.627	5.627
	Femra	100	100	120

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

FIG.33
Përqindja e zënies së kapacitetit në burgje



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, INSTAT

Personeli në burgje

Gjatë periudhës 2022-2024 vërehet një ulje e numrit të personelit në institucionet e vuajtjes së dënimit.

Në vitin 2024, personeli në burgje është 3.892 punonjës, 7,4 % më pak, krahasuar me vitin paraardhës dhe 9,4 % më pak krahasuar me vitin 2022.

Meshkujt përbëjnë shumicën e stafit në të gjitha vitet, mbi 80 %.

Sa i përket strukturës funksionale, pjesa më e madhe e punonjësve është e angazhuar në mbikëqyrje dhe siguri, e cila përbën mbi 75% të personelit total.

TAB.23

Personeli i burgjeve sipas gjinisë/sipas funksionit, gjatë vitit

		2022	2023	2024
Personeli i burgjeve	Gjithsej	4.296	4.201	3.892
	Meshkuj	3.503	3.602	3.128
	Femra	793	599	764
Personeli i burgut përgjegjës për:	Mbikëqyrje	3.151	3.271	2.980
	Edukim/Trajnim/Shëndetësi	386	364	127
	Administratë/Menaxhim/Të tjera	759	566	785

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve



ANEKS 1

TAB.1
Të dëmtuar sipas qarqeve

Qarku	2022	2023	2024
Berat	607	535	546
Dibër	327	325	352
Durrës	1.319	2.340	2.312
Elbasan	1.000	1.234	1.526
Fier	760	897	990
Gjirokaštër	411	504	404
Korçë	853	1.058	1.104
Kukës	300	327	360
Lezhë	726	836	1.025
Shkodër	797	768	955
Tiranë	5.252	7.024	6.911
Vlorë	1.298	985	1.192
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	0	185	84
Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit	0	3	0
Gjithsej	13.650	17.021	17.761

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Shënim: DPP përfshin rastet e evidentuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
DKM përfshin rastet e evidentuara nga Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit

TAB.2
Autorë sipas qarqeve

Qarku	2022	2023	2024
Berat	1.456	1.197	1.090
Dibër	1.080	866	746
Durrës	4.397	4.587	4.628
Elbasan	2.354	2.769	2.935
Fier	2.441	2.381	2.450
Gjirokaštër	1.233	1.071	882
Korçë	2.496	2.226	2.238
Kukës	964	908	800
Lezhë	1.917	2.062	2.041

Shkodër	2.203	2.112	2.265
Tiranë	15.033	15.053	15.287
Vlorë	2.624	2.784	2.602
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	0	936	1.075
Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit	0	537	1.018
Gjithsej	38.198	39.489	40.057

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Shënim: DPP përfshin rastet e evidentuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

DKM përfshin rastet e evidentuara nga Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit

TAB.3

Të dyshuar sipas veprave penale dhe shtetësisë

Vepra penale	2022		2023		2024	
	Shqiptarë	Të huaj	Shqiptarë	Të huaj	Shqiptarë	Të huaj
Vrasje me dashje	39	*	36	6	54	*
Vrasje të mbetura në tentativë	115	*	118	*	108	*
Shkaktim vetvrasje	16	*	17	*	22	*
Kanosja	994	4	1.189	4	1.219	10
Plagosje e rëndë me dashje	197	*	192	*	210	*
Plagosje e lehtë me dashje	1.119	4	1.309	3	1.376	9
Përdhunimi	55	*	52	*	47	*
Abuzime seksuale	114	*	86	*	97	*
Trafikimi i qenieve njerezore	48	*	46	*	76	25
Dhuna në familje (neni 130/a)	1.997	6	2.016	13	2.272	26
Shfrytëzim prostitucioni	142	*	261	3	152	59
Pornografia	102	*	26	*	69	*
Përndjekje	159	*	188	3	217	4
Vjedhje	1.975	21	2.502	30	1.913	43
Vjedhje me dhunë	118	*	115	*	93	*
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	122	*	51	*	52	*
Mashtrime	1.141	23	977	39	822	53
Fallsifikim monedhash	53	*	19	3	28	8
Punësim i paligjshëm	144	*	170	14	169	7
Pastrimi i parave	623	4	495	5	443	14
Krime në fushën e drogës	3.633	56	4.007	79	3.199	110
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	5.250	48	5.204	110	5.369	132
Krime kibernetike	44	*	107	22	194	35

Trafikimi i armëve dhe i municionit	1.465	9	1.716	22	1.544	29
Organizata kriminale	491	*	230	12	395	4
Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror	609	99	638	53	489	26
Dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit	557	73	296	60	187	21
Shtërngim ose pengim për të bashkëjetuar ose zgjidhur martesën	16	*	9	*	*	*
Korrupsion	674	8	373	4	339	7
Abuzim detyre	820	*	678	*	584	*
Ndërtim i paligjshëm	1.261	*	1.507	*	1.399	5
Vepra penale kundër mjedisit	644	*	627	*	565	3
Vepra penale të paklasifikuara	12.873	224	13.495	243	15.332	382
Gjithsej	37.609	589	38.752	737	39.037	1.020

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
* Vlera të fshehura për arsye të konfidencialitetit

TAB.4

Të burgosur sipas veprave penale dhe gjinisë, në fund të vitit

Vepra penale	2022			2023			2024		
	Meshkuj	Femra	Total	Meshkuj	Femra	Total	Meshkuj	Femra	Total
Vjedhje e pasurisë	725	8	733	742	10	752	640	10	650
Vrasje	929	15	944	939	15	954	843	13	856
Plagosje	96	*	96	100	*	100	80	*	80
Marrëdhënie seksuale me dhunë	44	*	44	41	*	41	21	*	21
Krime në fushën e drogës	1.366	11	1.377	1.525	14	1.539	1.367	14	1.381
Organizata kriminale	78	*	79	71	*	72	85	*	87
Mashtrime	108	9	117	122	7	129	96	6	102
Shfrytëzim prostitucioni	38	3	41	40	6	46	19	8	27
Trafikim qëniesh njerëzore	19	*	20	4	*	5	4	*	4
Pastrim i produkteve të veprës penale	8	*	8	7	*	7	*	*	*
Korrupsion	62	*	63	127	*	129	95	*	96
Të tjera	1.408	14	1.422	1.375	20	1.395	1.164	23	1.187
Gjithsej	4.881	63	4.944	5.093	76	5.169	4.414	77	4.491

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
* Vlera të fshehura për arsye të konfidencialitetit

TAB.5

Numri i veprave penale të përzgjedhura sipas kategorive të ICCS dhe qarqeve, 2024

Qarku	Kategoria sipas ICCS	Numri i veprave penale
Berat	Vrasje me dashje	0
	Plagosje (e rëndë dhe e lehtë)	62
	Vjedhje me dhunë	4
	Vjedhje me hyrje të paligjshme (gjithsej)	16
	Vjedhje banese	16
	Vjedhje makine	0
Dibër	Vrasje me dashje	*
	Plagosje (e rëndë dhe e lehtë)	57
	Vjedhje me dhunë	*
	Vjedhje me hyrje të paligjshme (gjithsej)	8
	Vjedhje banese	8
	Vjedhje makine	6
Durrës	Vrasje me dashje	6
	Plagosje (e rëndë dhe e lehtë)	297
	Vjedhje me dhunë	9
	Vjedhje me hyrje të paligjshme (gjithsej)	74
	Vjedhje banese	72
	Vjedhje makine	23
Elbasan	Vrasje me dashje	0
	Plagosje (e rëndë dhe e lehtë)	197
	Vjedhje me dhunë	3
	Vjedhje me hyrje të paligjshme (gjithsej)	15
	Vjedhje banese	15
	Vjedhje makine	7
Fier	Vrasje me dashje	5
	Plagosje (e rëndë dhe e lehtë)	102
	Vjedhje me dhunë	3
	Vjedhje me hyrje të paligjshme (gjithsej)	26
	Vjedhje banese	26
	Vjedhje makine	5
Gjirokastrë	Vrasje me dashje	3
	Plagosje (e rëndë dhe e lehtë)	37
	Vjedhje me dhunë	*
	Vjedhje me hyrje të paligjshme (gjithsej)	18
	Vjedhje banese	18
	Vjedhje makine	5

Qarku	Kategoria sipas ICCS	Numri i veprave penale
Korçë	Vrasje me dashje	*
	Plagosje (e rëndë dhe e lehtë)	127
	Vjedhje me dhunë	5
	Vjedhje me hyrje të paligjshme (gjithsej)	51
	Vjedhje banese	50
	Vjedhje makine	6
Kukës	Vrasje me dashje	*
	Plagosje (e rëndë dhe e lehtë)	58
	Vjedhje me dhunë	0
	Vjedhje me hyrje të paligjshme (gjithsej)	11
	Vjedhje banese	11
	Vjedhje makine	3
Lezhë	Vrasje me dashje	3
	Plagosje (e rëndë dhe e lehtë)	97
	Vjedhje me dhunë	4
	Vjedhje me hyrje të paligjshme (gjithsej)	21
	Vjedhje banese	21
	Vjedhje makine	12
Shkodër	Vrasje me dashje	4
	Plagosje (e rëndë dhe e lehtë)	85
	Vjedhje me dhunë	4
	Vjedhje me hyrje të paligjshme (gjithsej)	31
	Vjedhje banese	31
	Vjedhje makine	22
Vlorë	Vrasje me dashje	6
	Plagosje (e rëndë dhe e lehtë)	104
	Vjedhje me dhunë	9
	Vjedhje me hyrje të paligjshme (gjithsej)	41
	Vjedhje banese	41
	Vjedhje makine	4
Tiranë	Vrasje me dashje	11
	Plagosje (e rëndë dhe e lehtë)	855
	Vjedhje me dhunë	37
	Vjedhje me hyrje të paligjshme (gjithsej)	84
	Vjedhje banese	80
	Vjedhje makine	20

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

* Vlera të fshehura për arsye të konfidencialitetit

METODOLOGJIA

1. BURIMI I TË DHËNAVE

Të dhënat e këtij publikimi bazohen në burime administrative dhe janë siguruar nga institucionet kryesore të sistemit të drejtësisë penale: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, të cilat përbëjnë burimet kryesore të informacionit statistikor.

Për përpilimin e këtyre statistikave është zbatuar një metodologji e harmonizuar, e bazuar në funksionimin e sistemeve të informacionit të zbatuara nga secili prej institucioneve përkatëse. Kjo qasje metodologjike është në përputhje me udhëzimet e ICCS (Klasifikimi Ndërkombëtar i Krimeve për Qëllime Statistike), duke garantuar koherencë metodologjike dhe krahasueshmëri ndërkombëtare të të dhënave.

Të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme së Policisë së Shtetit përfshijnë numrin e veprave penale të evidentuara, viktimat/personat e dëmtuar dhe personat e dyshuar dhe të arrestuar.

Të dhënat e Prokurorisë së Përgjithshme përfshijnë numrin e procedimeve penale të regjistruara, procedimet e përcjella për gjykim dhe numrin e të pandehurve.

Të dhënat e Ministrisë së Drejtësisë përfshijnë numrin e personave të dënuar për vepra penale.

Të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve përfshijnë numrin e personave të dënuar me burg dhe të paraburgosur.

Të gjitha këto burime administrative janë thelbësore për sigurimin e një pasqyre të plotë dhe të qëndrueshme të funksionimit të sistemit të drejtësisë penale, për monitorimin e tendencave kriminale, si dhe për përmbushjen e afateve të raportimit dhe detyrimeve ndërinstitucionale.

2. MBLEDHJA E TË DHËNAVE

Të dhënat bazë janë siguruar nga: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Secili prej këtyre institucioneve prodhon statistika kryesisht për nevoja të brendshme administrative dhe operative, prandaj metodat e mbledhjes, përpunimit dhe raportimit të të dhënave mund të ndryshojnë nga njëri institucion te tjetri.

Në këtë seksion paraqiten informacione të përgjithshme mbi ofruesit e të dhënave, mënyrën se si secili institucion mbledh dhe administron informacionin, si dhe përshkrimi i të dhënave që INSTAT-i mbledh, përpunon dhe publikon nga secili prej këtyre burimeve administrative.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Mbledhja e të dhënave

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë grumbullon çdo ditë të dhëna direkt nga 12 drejtoritë rajonale të policisë. Një komunikatë me veprat penale të evidentuara i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë nga drejtoritë rajonale dhe pastaj këto vepra penale hidhen në sistem. Sistemi i policisë u krijua për herë të parë në vitin 2014 dhe mban të gjitha të dhënat që nga viti 2015 e në vijim. Përpara zbatimit të sistemit, të dhënat mblidheshin dhe hidheshin në exel me dorë në dosjet fizike. Sistemi ka fusha të detyrueshme, përputhshmëria dhe saktësia e të cilave kontrollohet dhe vlerësohet në Drejtorinë e Përgjithshme. Sistemi ka një numër të konsiderueshëm fushash sipas veprave penale (sipas nenit përkatës të kodit penal), autorët / të dyshuarit, modus operandi, ngjarja, viktimat, motivet, gjinia, shtetësia, sendet e konfiskuara, arrestimet, grupmosha dhe arsimi.

Bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet INSTAT-it dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, INSTAT-i mbledh të dhëna për veprat penale; viktimat/personat e dëmtuar të disaggreguara sipas gjinisë, dy grupeve kryesore moshore (të mitur, të rritur) dhe kombësisë (shqiptar, të huaj); të dhënat për personat e dyshuar sipas gjinisë, grupmoshës, nivelit arsimor dhe masave të sigurisë. Për vlerësimin e të dhënave kryhet kontrolli për plotësinë e tyre, përputhshmërinë me kalimin e kohës, kontroll përmblidhës vjetor, kontrolli i intervaleve kohore nëse ka informacione në vijim, etj.

Rregullat e metodologjisë:

- *Faza e mbledhjes së të dhënave:* Veprat penale regjistrohen në momentin që është kryer raportimi i veprës penale, ose është evidentuar nga policia, por përpara një hetimi të plotë.

- *Njësia e numërimit:* Veprat penale janë njësia kryesore e numërimit. Kur regjistrohen të dhënat e rastit, regjistrohen të gjitha veprat penale dhe jo vetëm vepra kryesore. Ndërsa rasti zhvillohet, zyrtarët që ndjekin këto raste sigurohen që sistemi të përditësohet me vazhdimësinë dhe rezultatet. Individët, personat e dyshuar dhe viktimat janë një njësi tjetër e numërimit që përdoret.

- *Rregullat e numërimit për veprat penale dhe personat:*

- Vepra të shumëfishta të të njëjtit lloj - veprat penale të të njëjtit lloj të kryera gjatë periudhave të ndryshme kohore numërohen si "dy ose më shumë vepra penale".
- Vepra e kryer nga më shumë se një person - në polici vepra penale numërohet vetëm njëherë ndërsa personat e dyshuar numërohen të gjithë.
- Numërimi i personave për vepra të shumëfishta (seriale) të të njëjtit lloj - kur një autorë ka kryer disa vepra të të njëjtit lloj në raste të ndryshme numërohet veçmas për secilën nga dy veprat penale.
- Numërimi i të njëjtit person disa herë në të njëjtin vit - një person që ka kryer vepra më shumë se një herë (në raste të veçanta) brenda një viti llogaritet si dy persona, për qëllime statistikore.

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

Mbledhja e të dhënave

Prokuroria e Përgjithshme mbledh të dhënat në mënyrë të drejtpërdrejtë nga 13 prokuroritë e shkallës së parë dhe nga Prokuroria e Posaqme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK). Procesi i mbledhjes së të dhënave është i unifikuar për të gjitha prokuroritë, dhe për këtë qëllim ekzistojnë udhëzime të shkruara që përcaktojnë mënyrën e regjistrimit dhe raportimit të rasteve.

Kur një rast penal i referohet prokurorisë, ai regjistrohet fillimisht në një regjistër manual. Në këtë regjistër përfshihen të gjitha veprat penale që lidhen me rastin, por për qëllime statistikore merret në konsideratë vetëm vepra penale kryesore ("rregulli i veprës kryesore penale").

INSTAT-i siguron nga Prokuroria e Përgjithshme informacion mbi: numrin e procedimeve penale të regjistruara sipas veprave penale; numrin e procedimeve të përcjella për gjykim; të dhëna mbi të pandehurit sipas gjinisë dhe grupmoshës.

Për të siguruar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e të dhënave, kryhen verifikime të shumta, përfshirë: kontrollin e plotësisë së të dhënave; vlerësimin e përputhshmërisë në kohë; korrigjime aritmetike në rast të mospërputhjeve (në nivele të pranueshme); kontrole përmbledhëse për koherencën e treguesve; analizë të serive kohore për të identifikuar shprehje ose devijime të konsiderueshme.

Rregullat e metodologjisë:

- *Faza e mbledhjes së të dhënave:* Procedimet penale regjistrohen në momentin që i referohen prokurorëve për ndjekje.
- *Njësitë e numërimit:* Njësitë bazë të numërimit janë procedimet penale dhe të pandehurit.
- *Rregulli i Veprës Kryesore Penale:* Kur një rast përfshin më shumë se një vepër penale, në statistika merret parasysh vetëm vepra më e rëndë.
- *Rregullat e numërimit për veprat penale dhe të pandehurit:*
 - Disa vepra të të njëjtit lloj të kryera nga i njëjti person numërohen si një rast.
 - Kur një vepër penale kryhet nga më shumë se një person, numërohet një rast penal, ndërsa të gjithë të pandehurit regjistrohen veçmas si individë.

MINISTRIA E DREJTËSISË

Mbledhja e të dhënave

Ministria e Drejtësisë publikon në faqen zyrtare të saj Vjetarin Statistikor. Burimi kryesor në sigurimin e informacionit statistikor janë Gjykatat e Shkallës së Parë, Gjykatat e Apeleve, Gjykata e Lartë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Shërbimi i Provës. Materiali statistikor përcillet në Ministrinë e Drejtësisë nëpërmjet formularëve të plotësuar me të dhënat sipas udhëzimeve përkatëse të Ministrit të Drejtësisë.

Në Vjetarin Statistikor ndeshim edhe analiza e konkluzione të dukurive të veçanta të shoqëruara me paraqitje grafike, tabelare, analiza krahasimore, ose me seri dinamike për rrethet gjyqësore, shkallë të ndryshme të gjyqësorisë, gjendjen aktuale të të dënuarve në Instucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, dënimeve alternative, por disa herë jepet edhe material bruto nga i cili mundet të veçohet elementi statistikor për të cilin interesohet përdoruesi i këtij informacioni.

Bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet INSTAT-it dhe Ministrisë së Drejtësisë, INSTAT siguron të dhëna për personat e dënuar sipas gjinisë dhe grupmoshës, llojin e veprave penale dhe masat e dënimit.

Rregullat e metodologjisë:

- *Faza e mbledhjes së të dhënave:* Faza e mbledhjes së të dhënave është para apelit; të dhënat publikohen para se vendimi të apelohej (për të dënuarit në shkallë të parë).

- *Njësia e numërimit:* Njësia e numërimit për statistikave është personi, i dënuari. Të dhënat e publikuara ndjekin rregullin e veprës kryesore për numërimin e personave të dënuar. Vetëm vepra penale më e rëndë do numërohet për autorin e cili kryen më shumë se një vepër penale njëkohësisht. Vepra kryesore penale është vepra me dënimit më të lartë.

- *Rregullat e numërimit për veprat penale dhe personat:*

- Veprat penale të shumëfishta të të njëjtit lloj: disa vepra penale të të njëjtit lloj numërohen si “një rast”.
- Rregulli i numërimit kur një vepër penale kryhet nga më shumë se një person: numërohet vetëm një rast ndërkohë që numërohen të gjithë autorët.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE

Mbledhja e të dhënave

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB) mbledh të dhënat drejtpërdrejt nga 21 institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (burgjet dhe paraburgimet) që funksionojnë aktualisht në Republikën e Shqipërisë. Procesi i mbledhjes së të dhënave është i unifikuar për të gjitha institucionet, dhe zbatimi i tij udhëhiqet nga udhëzime të shkruara dhe rregullore të miratuara nga DPB.

Në Regjistrin e Burgjeve regjistrohen të gjitha veprat penale për të cilat personat janë dënuar ose ndodhen në paraburgim. Për qëllime statistikore, zbatohet rregulli i “Veprës Kryesore Penale”, që nënkupton se për çdo person merret në konsideratë vetëm vepra më e rëndë penale, sipas dënimit maksimal të parashikuar nga Kodi Penal.

Në çdo institucion penitenciar plotësohet komunikata ditore, një dokument standard që përditësohet nga personeli i burgut. Ajo përmban informacione për çdo person të burgosur ose të paraburgosur, përfshirë të dhënat identifikuese dhe statusin e tij ligjor. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve mbledh, verifikon dhe konsolidon këto të dhëna dhe publikon statistika zyrtare mujore.

Regjistri përfshin të dhëna për të burgosurit për veprat penale, gjininë, moshën, të dhënat për të paraburgosurit, të burgosurit që ndjekin aktivitetet rehabilituese, kohëzgjatja në paraburgim, masat alternative, vdekjet në burgje, etj.

Bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet INSTAT-it dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, INSTAT-i mbledh të dhëna në bazë të formateve të burgjeve dhe publikon të dhëna për personat e burgosur sipas veprës penale dhe gjinisë, të dhëna për të paraburgosurit dhe të dënuarit me burg, nivelin arsimor, moshën, shtetësinë dhe aktivitetet rehabilituese. Kontrolli për plotësinë e të dhënave, përputhshmëria me kalimin e kohës, kontrolle përmbledhëse, kontrolli i serive kohore nëse ka shpëputje të konsiderueshme etj., kryehen për vlefshmërinë e të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Rregullat e metodologjisë:

- *Faza e mbledhjes së të dhënave:* Regjistrimi i personave fillon në momentin kur ata transferohen nga stacioni i policisë në institucionin e paraburgimit.

- *Njësia e numërimit:* Njësia bazë e numërimit është personi i burgosur ose i paraburgosur. Të dhënat e publikuara ndjekin parimin e “Vepres Kryesore Penale”, sipas të cilit, në rastet kur një person ka kryer më shumë se një vepër penale, për qëllime statistikore merret në konsideratë vetëm vepra penale më e rëndë, pra ajo për të cilën ligji parashikon dënimin maksimal.

3. KLASIFIKIMI I VEPRAVE PENALE

Klasifikimi i veprave penale në këtë botim është bazuar në nenet e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë dhe në Klasifikimin Ndërkombëtar të Krimeve për Qëllime Statistikore (ICCS). Ky klasifikim ndan veprat penale në 11 kategori kryesore, të cilat ofrojnë një strukturë të unifikuar për mbledhjen, analizimin dhe krahasimin e të dhënave kriminale në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Këto kategori janë:

1. *Veprime që çojnë në vdekje ose synojnë të shkaktojnë vdekje* - përfshin vrasjet dhe tentativat për vrasje.
2. *Veprime që shkaktojnë dëm ose synojnë të shkaktojnë dëm ndaj personit* - përfshin sulmet fizike dhe lëndimet trupore.
3. *Veprime seksuale me dëmtim* - përfshin përdhunimet dhe sulmet seksuale të tjera me dëmtim të viktimës.
4. *Veprime kundër pronës me dhunë ose kërcënim ndaj personit* - përfshin grabitjet dhe plaçkitjet me përdorim të dhunës.
5. *Veprime vetëm kundër pronës* - përfshin vjedhjet dhe dëmtimet e pronës pa përdorim të dhunës.
6. *Veprime që përfshijnë droga të kontrolluara ose substanca psikoaktive* - përfshin prodhimin, posedimin dhe trafikimin e drogës.
7. *Veprime që përfshijnë mashtrim, gënjeshtëri ose korrupsion* - përfshin mashtrimin financiar, korrupsionin dhe lloje të tjera të mashtrimeve.
8. *Veprime kundër rendit publik, autoritetit dhe dispozitave të shtetit* - përfshin rebelimin, mosbindjen civile dhe kundërshtimin e ligjit.
9. *Veprime kundër sigurisë publike dhe sigurisë së shtetit* - përfshin terrorizmin dhe kërcënimet ndaj sigurisë kombëtare.
10. *Veprime kundër ambientit natyror* - përfshin ndotjen dhe shkeljet e ligjeve mjedisore.
11. *Veprime të tjera penale të cilat nuk klasifikohen në ndonjë grup tjetër* - përfshin krime të veçanta që nuk mund të kategorizohen në një nga 10 grupet e para.

VEPRA PENALE SIPAS ICCS

Neni	ICCS	Vepra penale
76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, b, c, 81, 82, 83, 141	0101	Vrasje me dashje
76-22, 77-22, 78-22, 79-22, 79/a-22, 79/b-22, 79/c-22, 82-22, 83-22, 141_22	0102	Vrasje të mbetura në tentativë
99	01049	Shkaktim vetvrasje
83/a, 84, 84/a	020121	Kanosja
88, 88/a, 88/b	020111	Plagosje e rëndë me dashje
89	020111	Plagosje e lehtë me dashje
100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 105, 107/a	0301	Përdhunimi
108, 108/a	03012	Abuzime seksuale
110/a; 128/b	0204	Trafikimi i qenieve njerëzore
130/a	020111	Dhuna në familje (neni 130/a)
114, 114-2, 114/a, 115	0302	Shfrytëzim prostitucioni
117	030221	Pornografia
121/a	02082	Përndjekja
134	0502	Vjedhje
135	0502	Vjedhje me shpërdorim detyre
139, 140	0401	Vjedhje me dhunë
143, 143/a, 143/b, 144, 144/a, 145, 146	0701	Mashtrime
183	070211	Falsifikim monedhash
170/a	08082	Punësim i paligjshëm
287, 287/a	07041	Pastrim i parave
283, 283/a, 283/b, 284, 284/c, 284/ç, 285, 285/a, 285/b, 286, 286/a	0601-060129	Krime në fushën e drogës
290, 291	02063; 02072	Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor
192/b, 293/a, 293/b, 293/c, 293/ç	0903	Krime kibernetike
282/a, 278-280	09012	Trafikimi i armëve dhe i municionit
284/a, 333, 333/a, 334	0905	Vepra të lidhura me organizatat kriminale
297	08059	Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror
298	08051	Dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit
130	020292	Shtrëngim ose pengim për të bashkëjetuar ose zgjidhur martesën
164/a, 164/b, 244, 244/a, 245, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a-319/e, 328/b	07031	Korrupsion
248, 248/a, 249, 250, 251, 252, 254, 255, 258	07033	Abuzim detyre
199/a		Ndërtim i paligjshëm
201, 201/a,b,c,ç, 202, 202/a, 202/b, 203, 204, 205, 206, 206/a,b, 207, 207/a,b,c,ç	1001	Vepra penale kundër mjedisit

VEPRA PENALE PËR TË MITUR SIPAS ICCS

Neni	ICCS	Vepra penale
81	0101	Vrasje e foshnjës
89	020111	Dëmtime të tjera me dashje
100	030113	Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur
101	030111	Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç
108	030229	Vepra të turpshme
108/a	03012	Ngacmim seksual
110	020222	Heqja e paligjshme e lirisë
124	020611	Braktisja e fëmijëve të mitur
124/b	020329	Keqtrajtimi i të miturit
127	02021	Marrja e padrejtë e fëmijës
128	0809	Ndërrimi i fëmijëve
128/b	0204	Trafikimi i të miturve
129	11021	Shtytja e të miturve në krim
128/a	0809	Fshehja ose ndërrimi me dashje i fëmijës
124/a	020291	Marrje shpërblim për procese birësimi
192/b, 293/a, 293/b, 293/c, 293/ç	0903	Krime kibernetike

4. PËRKUFIZIME

Vepra penale të evidentuara: pasyron numrin e veprave penale të cilat janë raportuar dhe evidentuar si vepra penale nga policia.

Dhuna në familje: përfshihen ato akte si rrahja, apo vepër tjetër dhune, kanosja serioze për vrasje ose plagosja e rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ish bashkëshort, bashkëjetues apo ish bashkëjetues, fëmijë apo pjestar familjeje, me pasojë cënimin e intergritetit fizik, psikosocial dhe ekonomik të tij.

Procedim penal i regjistruar: i referohet procedimeve penale të reja të regjistruara për atë vit, jo rastet nga viti i kaluar, ose procedimet që janë rifilluar.

Procedime penale për gjykim: i referohen procedimeve të dërguara për gjykim në vitin referues, për të gjykuar kryerjen e veprës penale. Procedimet penale për gjykim në vitin referues i referohet procedimeve të regjistruara të të njëjtit vit, jo rasteve nga viti i kaluar, ose procedimet që janë rifilluar në atë vit.

Masat e dënimit: përfshin çdo masë të aplikuar nga një gjykatë ndaj personit të dënuar për një vepër penale.

Dënime alternative: Masa ndëshkuese ligjore që zëvendësojnë ose pezullojnë pjesërisht dënimin me burg, duke përdorur mjete të tjera ndëshkuese si dënimi me gjobë, heqja e së drejtës të ushtrimit të një profesioni ose një veprimtarie, gjysmëliria, qëndrimi në shtëpi, lirimi me kusht, detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik, përmbushja e detyrimeve të caktuara, pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provëmasat mjekësore dhe edukuese.

Përqindja e të paraburgosurve në privim lirie: shpreh numrin e përgjithshëm të personave të mbajtur në paraburgim që ende nuk janë dënuar, si përqindje e totalit të personave që gjenden në burgje.

Femicidi: vrasja e një gruaje ose vajze për shkak të gjinisë së saj.

STATISTIKAT E KRIMEVE DHE DREJTËSISË PENALE

2022-2024